

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5917  
E mërkurë, 30 tetor 2019  
çmimi 0.40 €

Lugina e Preshevës  
insiston në reciprocitet  
me të drejtat e serbëve në  
Kosovë | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", MAZLLUM BARALIU | FAQE 4-5



## Qeveria e re dhe opozita, me platformë unike për dialogun me Serbinë

Njohësi i proceseve politike dhe zgjedhore, Mazllum Baraliu, ka vlerësuar se qeveria e ardhshme duhet ta ndryshojë qasjen ndaj dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se duhet të jetë prioritet i qeverisë së re që të ulet së bashku me opozitën për hartimin e një

platforme të përbashkët për të shkruar në mënyrë unike në dialogun me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Baraliu ka thënë se nuk duhet të vonohet formimi i institucioneve të reja. Sipas tij, një prej prioritetëve të qeverisë së re duhet të

jetë reforma zgjedhore e cila do t'i eliminonte vonesat dhe gabimet që po ndodhin. Baraliu ka vlerësuar se procesi zgjedhor i 6 tetorit ka qenë një prej proceseve më të mira dhe më demokratike të zhvilluara ndonjëherë në historinë politike dhe në demokracinë tonë

## Hoti: Pas certifikimit të zgjedhjeve, marrëveshja në mes të LDK-së dhe LV-së për qeverinë

Anëtar i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka bërë me dije të martën se nuk ka zvarritje për arritjen e marrëveshjes për bashkëqeverisje në mes të LDK-së dhe Lëvizjes Vetëvendosje. Ai ka thënë se kjo marrëveshje do të ndodhë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve. Hoti ka treguar se qeveria e re do t'i ketë vetëm 12 ministri që do t'i kursejë shtetit miliona euro | FAQE 3



## Hiqet homologimi për automjetet e reja | FAQE 7

### OPINION

#### NDRYSHIMET PSIKOPOLITIKE PAS 6 TETORIT | F. 8

Shkruan:  
Blerim LATIFI



#### LËVIZJA KOMBËTARE E VITEVE TETËDHJETË DHE DY HERONJ TË SAJ, AFRIM ZHITIA E FAHRI FAZLIU | F. 12

Shkruan:  
Mehmet HAJRIZI



### AKTUALE

#### PËR NËNTË MUAJ 76 TË VDEKUR NË AKSIDENTE TRAFIKU | F. 9

### EKONOMI

#### PANXHA DHE DEMA NËNSHKRUAJMË MEMORANDUM BASHKËPUNIMI | F. 9

#### SEKTORI JOBANKAR NË KOSOVË, NË TREND TË MIRË TË ZHVILLIMIT | F. 9



### SPORT

#### BERISHA: SUKSESI, FALË PRESIDENTIT ARSIM KABASHI | F. 18

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



# Palmeri: SHBA-ja, partnere e fuqishme e Maqedonisë së Veriut

I dërguari i posaçëm amerikan për Ballkanin, Matthew Palmer, pas takimit me ministrin e Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut, ka thënë se Shtetet e Bashkuara mbeten partner i fortë i Maqedonisë së Veriut dhe mbështesin rrugëtimin e saj drejt BE-së



SHKUP, 29 TETOR - I dërguari i posaçëm amerikan për Ballkanin, Matthew Palmer, gjatë vizitës së tij në Shkup, takimin e parë e ka zhvilluar me ministrin e Jashtëm të Maqedonisë Veriore, Nikolla Dimitrov. Palmeri ka thënë se Shtetet e Bashkuara mbesin partnere e fuqishme në rrugëtimin e Maqedonisë së Veriut drejt integritetit euroatlantik. "Është kohë e shkëlqyer për vizitë, posaçërisht pas vizitës së sekretarit amerikan të Shtetit, Mike Pompeo. Dua të përcjell mesazhin tim se Shtetet e Bashkuara mbeten partner i

fortë i Maqedonisë së Veriut dhe mbështesin rrugëtimin e saj drejt BE-së. Ky është rajon që i përket Evropës dhe BE-ja nuk mund të jetë e suksesshme dhe e qetë nëse rajoni mbetet i vonuar", deklaroi Palmeri pas takimit me ministrin e Punëve të Jashtëm të Maqedonisë së Veriut, Nikolla Dimitrov, ka njoftuar rfe. Shefi i diplomacisë maqedonase deklaroi pas takimit me diplomatin amerikan se institucionet, edhe pas mosmarrjes së datës për nisjen e bisedimeve me BE-në, do të vazhdojnë punën me zbatimin e refor-

mave që të mos lënë asnjë arsye për ndonjë refuzim tjetër. Ai tha se Ballkani e ka vendin në Bashkimin Evropian pasi unioni, siç u shpreh ai, nuk do të jetë i suksesshëm me një rajon të lënduar.

"Në vitin 2008 kishim rënë në kurthin e dëshpërimit, mendoj se kjo nuk do të na çojë larg, nëse sërish biem. Duhet të jemi të vendosur. Duhet të përpiqemi që të largojmë edhe arsyetimin e fundit për mosd-

hënien e datës. Ky është Ligji i Prokurorisë Publike dhe në momentin e parë që vjen të dalim edhe më të përgatitur dhe të gjejmë mënyrën që së bashku me të gjitha shtetet anëtare të BE-së të gjejmë mënyra që edhe brengosjet e tyre të adresohen, por edhe të kemi parasysh interesin tonë. Kemi interesa të përbashkëta, pasi është një rajon i gjeografisë evropiane dhe nuk mundet Evropa të jetë e suksesshme dhe stabile me një rajon të lënduar", u shpreh Dimitrov.

I dërguari i posaçëm i Departamentit amerikan të Shtetit për Ballkanin, Matthew Palmer, gjatë vizitës në Maqedoninë e Veriut është takuar me ministrin e Mbrojtjes, Radmilla Sheqerinska ndërsa në ditët në vijim do të realizojë takimet edhe me drejtues tjerë të lartë shtetërorë.

## Meta nderohet me titullin e lartë nga presidentja e Kroacisë



TRANË, 29 TETOR - Gjatë vizitës shtetërore në Zagreb, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta është nderuar të martën në një ceremoni solemne, nga presidentja kroate Kolinda Grabar-Kitarović, me titullin më të lartë të Republikës së Kroacisë, "Urdhri i Lartë i Mbretit Tomislav me Shirin dhe Yllin e Madh", për kontributin dhe veprimtarinë e tij të spikatur në forcimin e marrëdhënieve midis dy vendeve dhe popujve tanë, dhe fqinjësisë së mirë midis vendeve të Ballkanit Perëndimor. Duke shprehur mirënjohjen e thellë për nderimin me titullin e lartë, presidenti Meta theksoi

ndër të tjera gjatë kësaj ceremonie:

"Ky vlerësim më motivon për të punuar pa u lodhur për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të shkëlqyera historike e tradicionale mes dy vendeve e popujve tanë në të gjitha fushat. Shqipëria dhe Kroacia, partnerë strategjikë, krah për krah në çdo sfidë!", theksoi presidenti Meta. Presidenti Ilir Meta ka nisur të martën vizitën e tij shtetërore dyditore në Kroaci, duke u pritur me nderime të veçanta nga presidentja kroate, Kolinda Grabar-Kitarović. Pas ceremonisë zyrtare së mirëseardhjes, presidenti Meta

zhvilloi një takim të ngrohtë dhe të përzemërt me presidenten Grabar-Kitarović dhe më tej, kryesuan bisedimet zyrtare mes delegacioneve respektive. Në përfundim të takimeve zyrtare presidenti Meta dhe presidentja Grabar-Kitarović dhanë një konferencë të përbashkët me gazetarë.

Presidenti Meta, në përfundim të takimit me presidenten kroate, vizitoi memorialin "Zëri i Viktimave Kroate - Muri i Dhimbjes" ku vendosi një kurorë me lule dhe u përul në kujtim dhe në respekt të martirëve të rënë për lirinë dhe pavarësinë e Kroacisë.

## Rama: Shqipëria është shembull për respektimin e të drejtave të pakicave

TRANË, 29 TETOR - Kryeministri, Edi Rama e ka konsideruar Shqipërinë një shembull të ndritshëm në respektimin e pakicave, përfshirë atë greke. Në një intervistë të dhënë për "Euronews Greqi", ai i ka konsideruar "marrëzi" reagimet nga disa anëtarë të pakicës greke, për ligjin e ri të shpronësimeve, të cilët frikësohen për pasuritë e tyre. "Shqipëria është një shembull i ndritshëm i respektit për të gjitha

pakicat dhe për grekët, të cilët kanë jetuar atje për shumë vite, në të njëjtat kushte si shqiptarët. Po, kur ka probleme, ato janë të njëjta për të gjithë, jo për një pakicë apo tjetrën. Pra, këto janë marrëzi", është shprehur Rama. Sipas kryeministrit shqiptar, e gjithë zhurma që po bëhet mbi këtë ligj ka të bëjë me agjenda politike. "Sa i përket ligjit, ne kemi punuar për një kohë të gjatë për të zgjidhur çështjet e pronave, shumë të



komplikuara pas rënies së komunizmit, pasi regjimi nuk lejonte asnjë pronë. Ajo që ne po përpiqemi të bëjmë është thjesht të riformulojmë legjislacionin

ekzistues për të mirën e të gjithëve, dhe të luftojmë një sistem korrupsioni që derdh mund të themi, gjakun e njerëzve për pronat e tyre. Por kjo nuk ka të bëjë vetëm me pakicën greke, por me të gjithë", ka deklaruar Rama. Sa i përket kufijve detarë midis dy shteteve, Rama është treguar i rezervuar në intervistë, duke përmendur vetëm progresin e arritur në disa pika me Qeverinë e mëparshme greke.

"Ne kemi punuar me qeverinë e mëparshme për disa kohë dhe kemi bërë përparim të konsiderueshëm. Duhet të vazhdojmë të punojmë me qeverinë e re, duke shpresuar se do të gjenet një konsensus", ka thënë Rama. Kryeministri është pyetur edhe mbi vdekjen e ekstremistit Kostandin Katsifas, në Bularat të Gjirokastrës. Rama i qëndroi deklaratës se ajo ngjarje ishte një "çmendur ekstremiste".



# Hoti: Pas certifikimit të zgjedhjeve, marrëveshja në mes të LDK-së dhe LV-së për qeverinë

Anëtari i Kryesisë i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka bërë me dije të martën se nuk ka zvarritje për arritjen e marrëveshjes për bashkëqeverisje në mes të LDK-së dhe Lëvizjes Vetëvendosje. Ai ka thënë se kjo marrëveshje do të ndodhë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve. Hoti ka treguar se qeveria e re do të ketë vetëm 12 ministri që do t'i kursejë shtetit miliona euro



jmë diskutimet për rendin, ligjin dhe sigurinë, për arsim dhe shëndetësi, pastaj për politikën e jashtme. Jam i bindur se mund ta përmbyllim marrëveshjen sapo të certifikohen rezultatet e zgjedhjeve. Pastaj, nuk do të humbim kohë për themelimin e institucioneve të reja", ka treguar Hoti. Ai ka thënë se të gjitha këto diskutime janë duke i mbajtur në mënyrë transparente sa iu përket temave dhe personave që po i zhvillojnë diskutimet. Sipas Hotit, një praktikë e tillë ka qenë e pazbatuar më parë në skenën politike.

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 29 TETOR** - Anëtari i Kryesisë i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, është shprehur i bindur se do ta përmbyllim marrëveshjen për qeverisje me Lëvizjen Vetëvendosje sapo të certifikohen rezultatet e zgjedhjeve nga KQZ-ja. Ai përmes një shkrimi në

llogarinë e vet në "Facebook" ka bërë me dije të martën se nuk ka zvarritje për arritjen e marrëveshjes për bashkëqeverisje në mes të LDK-së dhe LV-së. "Nuk ka zvarritje për arritjen e marrëveshjes për bashkëqeverisje në mes të LDK-së dhe LV-së. Qytetarët më 6 tetor kanë kërkuar ndryshim, duke votuar dy partitë opozitare pothuajse njëjtë, të cilat së bashku arrijnë

mbi 50 për qind të mandateve në Kuvend, të mjaftueshme për ta formuar qeverinë e re. Jemi duke punuar për t'u marrë vesh për një program qeverisës që reflekton këtë vullnet të qytetarëve", ka shkruar ai.

Hoti ka thënë se deri më tani janë pajtuar për madhësinë dhe

organizimin e qeverisë, e cila, sipas tij, do të ketë vetëm 12 ministri, që do të kursejë miliona euro dhe do ta rrisë efikasitetin e qeverisjes. "Kemi diskutuar programin për zhvillim ekonomik dhe punësim dhe jemi pajtuar për shumicën e çështjeve. Në takimet në ditët në vijim vazhdo-

Të hënën ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip S. Kosnett, ka takuar liderin e LV-së, Albin Kurtin dhe nënkryetaren e LDK-së, Vjosa Osmani. Në këto takime është diskutuar për formimin sa më të shpejtë të institucioneve të dala nga zgjedhjet e 6 tetorit.

## Lugina e Preshevës insiston në reciprocitet me të drejtat e serbëve në Kosovë

**PRISHTINË, 29 TETOR** - Përfaqësuesit politikë të shqiptarëve të komunave në jug të Serbisë, Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, që në terminologjinë politike njihen edhe si Lugina e Preshevës, presin që Qeveria e re e Kosovës të merret më seriozisht me çështjen e shqiptarëve të Luginës. Ndër të tjera, ata presin nga qeveria e ardhshme dhe, siç thonë, kryeministri në ardhje, Albin Kurti, të reflektojë pozitivisht karshi kërkesave për përfshirjen e tyre në kuadër të dialogut politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Kryetari i Komunës së Bujanocit, Shaip Kamberi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë", se menjëherë pas formimit të Qeverisë së re të Kosovës do të kërkojnë takim me kryeministrin e ri për t'ia parashtruar kërkesat, por edhe për ta njoftuar me problemet me të cilat po përballen popullata shqiptare në Luginë. Sipas tij, Albin Kurti, i cili pritet të jetë mandatar për formimin e qeverisë, është zotuar për ndryshim të gjendjes në Luginë. "Presim që qeveria e ardhshme të jetë shumë më aktive në drejtim të ndihmës konkrete drejt Luginës së Preshevës sepse aktualisht ne përballemi me një

situatë, ndër më të rëndat në historinë tonë më të re. Largimi në masë i njerëzve për shkak të problemeve të shumta politike dhe ekonomike po e dobëson bërthamën kombëtare. Është momenti i fundit që Prishtina e Tirana zyrtare ta kuptojnë këtë dhe të kenë projekte konkrete të ndihmës së drejtpërdrejtë për Luginën e Preshevës", ka thënë Kamberi.

Përfaqësuesit e Luginës së Preshevës thonë se po e presin me interesim edhe vazhdimin e dialogut për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Në kuadër të këtij dialogu, të lehtësuar nga Bashkimi Evropian, përfaqësuesit e serbëve të Kosovës kanë qenë pjesë e delegacionit të Serbisë. Kështu që edhe përfaqësuesit shqiptarë të komunave Preshevë, Medvegjë e Bujanoc thonë se do të kërkojnë nga pala kosovare që t'i përfshijë ata në delegacionin e Kosovës. "Pavarësisht se cilin opsion do ta zgjedhë Kosova në raport me Serbinë në bisedimet e ardhshme, nuk mund të tolerohet që në Ballkan të ketë situatë që të ketë pakica të privileguara, siç janë serbët e Kosovës, në ndërkohë që neve (shqiptarëve të Luginës së



Preshevës) na mohohen edhe ato të drejta më elementare që vetë Kushtetuta e Serbisë i parasheh", ka deklaruar Kamberi.

Ndërkaq kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Luginën e Preshevës, Ragmi Mustafa, ka thënë për REL se Qeveria e re e Kosovës në mënyrë sistematike dhe programore duhet t'u qaset çështjeve jetike të shqiptarëve në Luginë të Preshevës. "Ne presim që të ketë një vëmendje të shtuar, të ketë një program të veçantë dhe strategjik se si duhet qasur Luginës së Preshevës, marrë parasysh që Lugina është pjesë e kontestit

historik, jetik të Kosovës. Ne konsiderojmë se të gjitha kërkesat që kemi pasur dhe që i kemi edhe sot, vetëm duhet pasur vullnet e strategji për t'iu qasur zgjidhjeve", ka thënë Mustafa. Nga ana tjetër, Liburn Aliu, anëtar i kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje, parti kjo që në bazë të rezultatit preliminar të zgjedhjeve të 6 tetorit, pritet ta formojë Qeverinë e re të Kosovës, ka thënë për REL se Vetëvendosje në radhë të parë, karshi Serbisë, ka qëndrimin për vendosjen e parimit të reciprocitetit.

Aliu ka shtuar se kërkesa për reciprocitet është e shprehur në

një deklaratë të përbashkët nga këshilltarët komunalë të komunave në Luginën e Preshevës, qysh në vitin 2006. "Mbi bazën e reciprocitetit të plotë karshi Serbisë, ky do të jetë parimi themelor kur bëhet fjalë për të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë. Nga ana tjetër, përmes institucioneve të Kosovës do të bëjmë çmos që të jemi në koordinim edhe me institucionet në Republikën e Shqipërisë që t'u jemi në ndihmë qytetarëve të Luginës", ka thënë Aliu.

Po ashtu, ai ka thënë se institucionet e Kosovës duhet t'u krijojnë disa lehtësi qytetarëve nga Lugina e Preshevës, marrë parasysh se edhe në Kosovë ata janë ballafaquar me pengesa të ndryshme.

Çështja e tri komunave në jug të Serbisë ishte përmendur shpesh edhe nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Ai ka deklaruar shumë herë publikisht se do të angazhohet që në kuadër të, siç kishte deklaruar, korrigjimit të kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, këto tri komuna të kalojnë në territorin e Kosovës.

Megjithatë, ideja e ndryshimit të kufirit të cilën Thaçi e ka potencuar shpesh, në spektrin politik në Kosovë, por edhe më gjerë, nuk kishte gjetur mbështetje.



Flet për "Epokën e re", Mazllum Baraliu

# Qeveria e re dhe opozita, me platfo

Njohësi i proceseve politike dhe zgjedhore, Mazllum Baraliu, ka vlerësuar se qeveria e ardhshme duhet ta ndryshojë qasjen ndaj dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se duhet të jetë prioritet i qeverisë së re që të ulet së bashku me opozitën për hartimin e një platforme të përbashkët për të shkuar në mënyrë unike në dialogun me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Baraliu ka thënë se nuk duhet të vonohet formimi i institucioneve të reja. Sipas tij, një prej prioriteteve të qeverisë së re duhet të jetë reforma zgjedhore e cila do t'i eliminonte vonesat dhe gabimet që po ndodhin. Baraliu ka vlerësuar se procesi zgjedhor i 6 tetorit ka qenë një prej proceseve më të mira dhe më demokratike të zhvilluara ndonjëherë në historinë politike dhe në demokracinë tonë

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 29 TETOR -

**"Epoka e re":** Z. Baraliu, si e komentoni procesin zgjedhor dhe ecurinë e deritanishme të tij?

**Baraliu:** Procesi elektoral i 6 tetorit ishte një prej proceseve më të mira dhe më demokratike të zhvilluara ndonjëherë në historinë politike dhe në demokracinë tonë. Ishte proces i qetë, pa incidente dhe pa shkelje serioze të cilat do të mund ta dëmtonin. Ky proces përfundoi me një efikasitet të paparë të KQZ-së duke arritur për disa orë t'i publikojë rezultatet preliminare. Ndërsa ankesat dhe rinumërimi i më shumë se 800 vendotimeve mendoj se janë pjesë natyrale e procesit.

**"Epoka e re":** Por rinumërimi ka evidentuar dhjetëra gabime qofshin ato me apo pa dashje.

**Baraliu:** Nuk ka proces pa gabime, madje gabimet që po i përmendni janë simbolike. Janë gabime teknike. Në një rubrikë të caktuar, në një formular, nuk është shënuar një numër i duhur, por edhe gabimet njerëzore që kanë qenë rrjedhojë e lodhjes së tepërt të komisionarëve dhe pjesëmarrësve në proces. Mirëpo e rëndësishme është se nuk ka pasur manipulime. Në disa vendotime ku janë rinumëruar me qindra fletëvotime vetëm një apo dy vota janë kontestuese dhe ato kanë mundur të korrigjohen nga kontrolli i dyfishtë në QNR dhe nuk ka pasur nevojë për rinumërim. Në tërësi rinumërimi nuk e ka cenuar procesin zgjedhor i cili është zhvilluar në përputhje me standardet

evropiane. Procesi elektoral ka treguar kulturë dhe pjekuri demokratike të të gjithë aktorëve pjesëmarrës. E vetmja vërejtje që mund t'i bëhet është zvarritja pa nevojë si dhe vendimet kontradiktore të institucioneve nga KQZ-ja, PZAP-i e deri te Gjykata Supreme.

**"Epoka e re":** Këto gabime e vonesa do t'i eliminonte reforma zgjedhore?

**Baraliu:** Po. Reforma zgjedhore është e domosdoshme tash e sa vite për arsye se Ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe Ligji për zgjedhjet lokale janë trashëgimi e administratës së UNMIK-ut dhe të papërpunuara mirë, madje janë kontradiktore dispozita me dispozitën dhe neni me nenin. Prandaj për reformë zgjedhore ka nevojë gjithsesi, por edhe më tutje mungon vullneti politik. Duhet rikujtuar se para disa vjetësh Kuvendi pati formuar Komisionin Parlamentar për hartimin e ligjit të ri për zgjedhjet e përgjithshme i cili ka paraparë reformën që nga zonat zgjedhore e deri te pragu zgjedhor, por mungesa e vullnetit politik ka pamundësuar jetësimin e këtij ligji. E njëjta gjë pati ndodhur edhe me reformën kushtetuese. Reforma elektorale është imperativ kohe, e pashmangshme dhe imediate. Qeveria e re duhet ta ketë reformën zgjedhore ndër prioritetet e para nëse dëshiron ta avancojë demokracinë si dhe të ketë mungesë të gabimeve që po ndodhin. Ka shumë gjëra që duhet të reformohen dhe kjo do të bëhej më së miri me përpilimin e një kodi zgjedhor ku do të përfshihen Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, Ligji



për zgjedhjet lokale, Ligji për financimin e partive politike dhe rregullat zgjedhore të KQZ-së.

**"Epoka e re":** Aktualisht është duke vazhduar 'beteja' për vota që kanë ardhur nga diaspora pas 6 tetorit, mbi 4 000 sosh. Si

duhet të veprohet me këto vota dhe votat e ardhura nga Serbia? **Baraliu:** Votat e ardhura në mënyrë të kundërligjshme nga



# frëmë unike për dialogun me Serbinë

4 000 vota të ardhura pas 5 tetorit nga diaspora janë objekt i Gjykatës Supreme dhe PZAP-it. Mendoj se këto vota janë të padiskutueshme dhe Supremja ka vepruar drejt duke sugjeruar PZAP-in që të urdhërojë KQZ-në t'i numërojë sepse qytetarët tanë në diasporë e kanë shfrytëzuar të drejtën e votës brenda afatit dhe nuk është as faji i tyre se ato kanë mbërritur pas 5 tetorit. Formalo-juridikisht PZAP-i ka të drejtë që ta konsiderojë shkelje sepse formalisht nuk është arritur afati, pra ka kaluar 5 tetori, por që nuk është faji i tyre vonesa. Vendimet kontradiktore dhe me standarde të dyfishta nuk i kontribuojnë mbarëvajtjes së procesit. Do të duhej që të njëjtin standard që ka pasur KQZ-ja ndaj votave të ardhura nga Serbia ta aprovojë edhe ndaj votave të diasporës, pra t'i pranojë edhe këto. Paraprakisht KQZ-ja pati marrë një vendim të drejtë dhe pragmatik për moslejimin e votimit me dokumente të tjera, përveç dokumenteve zyrtare të Republikës së Kosovës.

**"Epoka e re":** Bazuar në këtë proces zgjedhor dhe rezultatin përfundimtar, si e shihni konstituimin e Kuvendit dhe formimin e qeverisë?

**Baraliu:** Procesi nuk duhet të zvarritet dhe nëse nuk ka ankesa të tjera duhet të bëhet shpallja e rezultateve përfundimtare dhe certifikimi i tyre. Pastaj presidenti në afat prej një muaji është i obliguar që ta caktojë mbledhjen e parë konstituive të Kuvendit ku zgjedhën organet e tij dhe pastaj formohet qeveria. Do të ishte mirë që të mos ketë zvarritje të mëtutjeshme, sepse është fundi i vitit dhe duhet aprovuar Ligji për buxhetin i cili nuk mund të procedohet nga qeveria në dorëheqje, por duhet nga qeveria e re si dhe çështjet e tjera që presin.

**"Epoka e re":** Cilat mendoni se do të jenë problemet dhe sfidat e qeverisë së ardhshme?

**Baraliu:** Gabon shumë kushdo që mundohet të kalkulojë në zvarritje të procesit dhe përfitim të përkohshëm qoftë në vendimmarrje, qoftë në pengim të krijimit të institucioneve të reja. Nuk do të duhej që të mbahet peng procesi dhe formimi i institucioneve. Ka nevojë që të veprohet me urgjencë dhe të merret mandati nga fitimtarët e rinj në mënyrë që të vazhdohet zgjidhja e shumë problemeve me të cilat jemi ballafaquar këto vite.

**"Epoka e re":** Çfarë pritjesh keni nga dialogu që do të drejtohet nga qeveria e re?

**Baraliu:** E shoh si një imperativ të domosdoshëm të qeverisë së re. Duhet të jetë prioritet i qeverisë së re që të ulet së bashku me opozitën për hartimin e një platforme të përbashkët për të shkuar në mënyrë unike në dialogun me Serbinë. Pastaj Brukseli dhe Beogradi duhet të kenë frymë dhe përgjegjësi tjetër ndaj Kosovës, pra Kosova në këtë proces nuk do të jetë e defaktorizuar si subjekt i pabarabartë dhe të pranojë të bisedojë për çështjet e brendshme me Serbinë. Moszbatimi i marrëveshjeve të arritura me Serbinë ka bërë që Kosova të stagnojë si në procesin e

njohjeve, po ashtu edhe në procesin e anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Do të duhej një platformë unike pozitive-opozitive e vendosur në parime dhe kërkesa ndaj Serbisë.

**"Epoka e re":** Prisni avancim në çështjet e brendshme dhe në agjendën evropiane?

**Baraliu:** Duke pasur parasysh dinamikën e takimeve të partnerëve të koalicionit të ardhshëm pres që të ketë harmonizim dhe bashkim të politikave dhe platformave si në aspektin e brendshëm, po ashtu edhe në atë të jashtëm. Qeveria e re do të ketë një qasje tjetër në dialog me Serbinë, ku fillimisht do të dialogohet me

serbët lokalë, pastaj me Serbinë pa u ngutur, sepse ngutja nuk e përcakton përmbajtjen. Kosova nuk ka nevojë të ngutet, dialogu nuk është i ngutshëm për Kosovën, por është zgjidhje e problemeve të brendshme nga ekonomia e deri te arsimiti, shkenca dhe kultura. Nuk duhet të ketë përmbushje të kërkesave të Serbisë për çështje të brendshme dhe për interesa të saj në dëm të interesave të Kosovës, duke diskutuar kryesisht për punë të brendshme të Kosovës deri te vendosja në tavolinë e pasurive natyrore dhe e territorit. Kjo nuk ishte as rruga dhe as platforma e duhur por, përkundrazi, ishte e papranueshme dhe kjo praktikë duhet të ndryshohet.



## Thaçi dhe Daka diskutojnë për certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve

**PRISHTINË, 29 TETOR (ER)** - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka takuar të martën kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, me të cilën ka biseduar për procesin e certifikimit të rezultateve

të zgjedhjeve që t'i hapet rrugë konstituimit të Kuvendit të Kosovës dhe formimit të Qeverisë së re të Kosovës. Me këtë rast kryetarja Daka e ka njoftuar presidentin Thaçi për hapat për përmbylljen e procesit të numërimit të votave dhe certi-

fikimin e rezultateve të zgjedhjeve të përgjithshme të mbajtura në fillim të këtij muaji. Presidenti Thaçi ka vlerësuar kryetaren Daka për punën, integritetin dhe profesionalizmin e KQZ-së për menaxhimin e procesit të përgjithshëm elektoral.

Serbia tashmë janë numëruar dhe KQZ-ja i ka pranuar pavarësisht prej kundërshtimit të disa anëtarëve. Më shumë se



## Ndërron jetë nënoficeri i FSK-së, Baki Ejupi

PRISHTINË, 29 TETOR (ER) - Ministria e Mbrojtjes ka njoftuar se të martën në vendin e tij të punës, pas një sulmi kardiak, ka ndërruar jetë nënoficeri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, kapter Baki Ejupi. Kapteri Baki Ejupi ka lindur më 08. 05. 1974 në fshatin

Sekiraqë, Komuna e Podujevës. Ai ka shërbyer me përkushtim të madh në Brigadën e Reagimit të Shpejtë të Batalionit të Tretë në Mitrovicë, që nga themelimi i Forcës së Sigurisë të Kosovës. Baki Ejupi qysh herët iu bashkua Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës në Zonën Operative të Llapit, Brigada 152, ndërsa me krijimin e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës ka shërbyer në Zonën e Pestë të TMK-së.

Kapter Baki Ejupi pas vetes ka lënë bashkëshorten dhe tre fëmijë, dy djem dhe një vajzë.



## Në Mitrovicë hapet punëtoria e dizajnit dhe zhvillimit urban

MITROVICË, 29 TETOR (ER) - Nënkyetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, të martën ka marrë pjesë në hapjen e punëtorisë së dizajnit dhe zhvillimit urban për planifikim, të lagjeve të qytetit të Mitrovicës, projekt ky i përbashkët në mes të Komunës së Mitrovicës, UBT-së dhe UN-Habitat-it. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe rektori i kolegjit privat UBT, Edmond Hajrizi, përfaqësuesit nga UN Habitat, në krye me këshilltaren teknike Gwendoline Mennetrier, anëtarët e grupit punues, si dhe studentët e përzgjedhur për ta ndjekur këtë punëtorinë.

Me këtë rast nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, ka falënderuar organizatorët e këtij projekti duke përzgjedhur Mitrovicën të parën, për të realizuar një projekt të tillë, i cili ka të bëjë pikërisht me zhvillimin e kreativitetit te studentët tanë. Po

ashtu, nënkryetari Mujka ka theksuar se ky projekt do të mundësojë që Komuna e Mitrovicës të përfitojë përvoja profesionale dhe ide inovative nga ekspertët dhe studentët e fushave përkatëse për zgjidhjen e problemeve të komunitetit.

Përmes këtij projekti punëtoria e dizajnit dhe zhvillimit urban për planifikim ka mbledhur disa studentë nga Kolegji UBT, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini", si dhe nga Kolegji Ndërkombëtar i Biznesit - Mitrovicë (IBC-M), të cilët kanë përgatitje akademike përfshirë në fushat: arkitekturë, planifikim urban, mjedis, sociologji dhe ekonomi, ku në bashkëpunim me grupin punues bazë të projektit dhe komunitetet e lagjeve do të mblidhen për t'i ndarë përvojat, idetë, si dhe për të dhënë ekspertiza profesionale në këtë drejtim.



## Komuna e Suharekës mbajti takimin informues për biznese dhe shoqëri civile

SUHAREKË, 29 TETOR (ER) - Komuna e Suharekës, në bashkëpunim me Agjencinë për Zhvillim Rajonal-Jug, kanë mbajtur takimin informues për biznese dhe shoqëri civile/institucione për prezantimin e dy skemave të granteve të BE-së. Qëllimi i ndarjes së këtyre granteve është përmirësimi i qasjes në tregun e punës për grupet e pafavorizuara përmes ndërmarrjeve sociale dhe masave aktive të punës si dhe zhvillimin e bizneseve. Në këtë takim informues do të shpalosen objektivat e skemës, çështjet me prioritet, shumat e



përkrahjes financiare, përqindja e bashkëfinancimit në projekt, kushtet e kualifikueshmërisë, partneritetet, llojet e aktiviteteve si dhe procedurat dhe afati i aplikimit.

## Gjilani nis aksionin për lirim e hapësirave publike nga uzurpatorët

GJILAN, 29 TETOR (ER) - Drejtoria e Inspeksionit në Gjilan ka nisur aksionin për lirim e hapësirave publike nga uzurpatorët. Gjatë javës së fundit janë liruar hapësirat e uzurpuara në qendër të qytetit, që përfshihen edhe largimi i disa mureve (penge-save), rrënim i objekteve mbi pronën publike të lumit Stanishorka, sikurse edhe objekteve të tjera me rrezikshmëri të lartë.

Drejtori i Inspeksionit, Nevzad Rushit, ka deklaruar se Komuna e Gjilanit nuk do të ketë tolerancë për uzurpatorët e pronës



publike, përfshirë edhe ndërmarrjet publike apo institucionet e tjera për të shtuar se ky aksion do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

## Në QKUK kryhet një operacion i rrallë

PRISHTINË, 29 TETOR (ER) - Në Klinikën e Kirurgjisë Abdominale të Qendrës Klinike Universitare, me metoda bashkëkohore, pa

ndonjë komplikim, mjekët kanë kryer një operacion të rrallë. "Sindroma Bouvert është një sëmundje specifike që rezulton me mbylljen e zor-

rës së hollë nga një gur si pasojë e fistullës së krijuar mes tëmthit dhe zorrës dymbëdhjetëgjishtore. Pacienti ka qenë nën mbikëqyrjen e

mjekëve për dy javë dhe tash është liruar në shtëpi me gjendje të mirë shëndetësore", është bërë me dije në njoftimin e QKUK-së.





## Për nëntë muaj, 76 të vdekur në aksidente trafiku

PRISHTINË, 29 TETOR - Mosrespektimi i ligjit dhe rregullave në trafik ka bërë që aksidentet rrugore të shndërrohen në një prej problemeve shumë serioze në Kosovë. Vetëm gjatë muajve janar-shtator 2019, sipas Policisë së Kosovës, 76 persona kanë vdekur në 66 aksidente, ndërsa 8.625 persona janë lënduar.

Në shumicën e rasteve, sipas policisë, fajtor është faktori njeri dhe tejkalimi i shpejtësisë së lejuar për ngasje. Gjatë këtij viti, përkatësisht gjatë periudhës janar-shtator, janë

regjistruar gjithsej 11 732 aksidente, që në një llogaritje të thjeshtë i bie rreth 43 aksidente brenda një dite. Autoritetet e rendit thonë se kanë shqiptuar mijëra gjoba, kryesisht për shkelje të rregullave në trafik dhe tejkalim të shpejtësisë. Këto të dhëna janë paraqitur gjatë një prezantimi mbi sigurinë në trafikun rrugor në Kosovë.

Jeton Rexhepi, drejtor i Departamentit Rrugor në Policinë e Kosovës, ka thënë se shumica e personave të lënduar apo që kanë përfunduar me

fatalitet janë të moshës mbi 19 vjeç. Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, nga viti 2002 deri në vitin 2018 numri mesatar i personave që kanë humbur jetën brenda një viti është 142 veta. Marrë parasysh këtë numër të viktimitave në trafik, për një vend me popullatë prej rreth 1.8 milion banorësh sa ka Kosova, Rexhepi ka shtuar se ka nevojë për një edukim dhe vetëdijesim më të madh të qytetarëve. "Nëse flasim për periudhën janar-shtator 2019 dhe e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar,



mund të them se, përveç aksidenteve me dëme, që shënojnë një rritje për 2.6 për qind, të gjitha llojet e aksidenteve kanë shënuar rënie. Në këtë periudhë

kohore janë 76 persona që kanë humbur jetën, ndërsa vitin e kaluar kanë qenë 90 persona, që do të thotë se kemi 14 persona më pak", ka thënë Rexhepi.

# Presidenti Thaçi: FSK-ja është e gatshme t'i ndihmojë forcimit të paqes



Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka pritur të martën në takim ekipin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) që ka marrë Medaljen e Argjendtë në garën ndërkombëtare "Cambrian Patrol" në Britaninë e Madhe. Thaçi ka thënë se FSK-ja është e gatshme t'i ndihmojë forcimit të paqes kudo që ka nevojë

**EPOKA E RE**

**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 29 TETOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të martën ka pritur ekipin

e Forcës së Sigurisë së Kosovës që ka marrë Medaljen e Argjendtë në garën ndërkombëtare "Cambrian Patrol" në Britaninë e Madhe. "Ky është një sukses i radhës, sepse ky

ekip i mrekullueshëm, këta ushtarë të përgatitur, vazhdimisht po arrijnë suksese kudo në botë", u shpreh presidenti Thaçi.

Kreu i shtetit theksoi se Forca e

Sigurisë së Kosovës është ushtri moderne, e përgatitur nga shtetet partnere të Republikës së Kosovës. "Forca e Sigurisë së Kosovës është shumë mirë e përgatitur, është forcë shumetnike e cila tashmë është e gatshme t'i ndihmojë forcimit të paqes kudo që ka nevojë", ka thënë presidenti Thaçi.

Në këtë garë prestigjioze botërore, në të cilën morën pjesë edhe ekipe nga vendet e rajonit, shumica e shteteve

konkurrojnë me njësitë e veta speciale. Kjo është hera e tretë që Forca e Sigurisë së Kosovës po merr pjesë në këtë garë ndërkombëtare ushtarake dhe ekipi i saj këtë vit ka arritur ta fitojë Medaljen e Argjendtë. Gara patrulluese kishte nisur më 16 tetor 2019 dhe kishte zgjatur gjithsej 48 orë pandërprerë. Në këtë garë ushtarake morën pjesë 132 ekipe, prej të cilave 34 ekipe ishin nga shtetet të ndryshme të botës.

## Hiqet homologimi për automjetet e reja

PRISHTINË, 29 TETOR (ER) - Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ka njoftuar qytetarët se duke u bazuar në legjislacionin në fuqi ka filluar procedurat e liberalizimit të procesit të homologimit. "Në kuadër të kësaj ju informojmë se MIT-ja ka marrë vendim që veturat e reja, të importuara nga kom-

panitë e licencuara, nuk do t'i nënshtrohen më homologimit nga kompania e autorizuar për ta kryer atë. Për verifikimin e të dhënave nga prodhuesit, përgjegjës do të jenë kompanitë e autorizuar për shitjen e tyre në tregun e Kosovës. I njëjti verifikim do të vlejë edhe për blerësit kur kryejnë regjistrimin

e veturave", është thënë në njoftimin e kësaj ministrie. Sipas Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, ky është një hap i ndërmarrë nga ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, për lehtësimin e procedurave dhe uljes së kostos të cilën duhet të paguajnë qytetarët.





# NDRYSHIMET PSIKOPOLITIKE PAS 6 TETORIT



Shkruan: Blerim LATIFI

Aktivizimi i madh i diplomatëve perëndimorë, ende pa u ndërtuar qeveria e re e Kosovës, duket qartë se ka për qëllim ta imponojë agjendën e parë me të cilën do të merret kjo qeveri. Në thelb të kësaj agjende është dialogu me Serbinë. Krejt ato gjëra që partitë politike kanë premtuar gjatë fushatës elektorale, detyrimisht, kanë për t'u lënë anash, për një periudhë ta caktuar. Perëndimi, e në mënyrë të veçantë ShBA-ja, janë duke u ngutur shumë për gjetjen e një zgjidhje përfundimtare midis Kosovës dhe Serbisë. Barriera e parë në të cilën do të ndeshet kjo ngutje është klima konfliktuale e politikës në Kosovë. Në pesë vjetët e fundit kjo klimë e ka dëmtuar shumë rëndë pozicionin

ndërkombëtar të Kosovës. Nga viti 2017, e deri në rënien e Qeverisë Haradinaj, Kosova ka kaluar nëpër një situatë absurde, në rrafshin e politikës së jashtme. Ne nuk kemi pasur politikë të jashtme unike. Kemi pasur politikë të jashtme, aq sa kemi edhe parti politike. Për më tepër vetë koalicioni në pushtet gjithë kohën ka qenë i ndarë në tri pozicione të ndryshme: ndryshe mendonte presidenti, ndryshe kryeministri dhe ndryshe prej të dyve kryetari i Kuvendit. Ndërkaq, përpjekja për t'i tejkaluar dallimet me anë të një ekipi të përbashkët për dialogun, doli sa qesharake, aq edhe në kundërshtim me kushtetutën. Duke marrë parasysh gjithë këtë, problemi i parë të cilin duhet ta tejkalojnë partitë parlamentare, është gjetja e një formule për të ndjekur një politikë të jashtme të unifikuar. Mesazhi fillestar që do të jepej, nëse kjo gjë arrihet, do të ishte mesazhi se Kosova është një shtet serioz, e jo një konglomerat pushtetesh partiake. Për këtë, mes tjerash, janë të

domosdoshme edhe transformimet psikopolitike të partive politike dhe liderëve të tyre. Çfarë kam në mendje me këtë term? Çdo pozicion politik bartë në vete një lloj psikologjie dhe kjo psikologji bëhet më e fuqishme, sa më shumë që zgjatë në kohë pozicioni politik. Kështu, p.sh. Lëvizja Vetëvendosje! ka një periudhë 14-vjeçare si subjekt opozitar. Ajo është e mishëruar me logjikën e kundërshtimit e refuzimit të politikave të pushtetit. Tani u duhet të ndryshojnë psikopolitikisht. Vetë Kurti i duhet të bëjë ndryshimin e tij të madh personal. Si lider opozitar, ai ndjehej komod në ligjërimin e tij moralist e populist, ndërsa tani, me të marrë postin e kryeministrit, që në ditën e parë të punës, do të ballafaqohet me të vërtetën e hidhur se politika nuk është vetëvendosje, por një art i bezdisshëm i negocimit dhe kompromisit të interesave e ideve. Sapo të pranojë këtë të vërtetë, ai do të detyrohet t'i

zhgënjej militantët idealistë që presin prej tij qoftë mrekulli, qoftë hakmarrje për vuajtjet e të kaluarës. Opozita e re, në anën tjetër, po ashtu, duhet të futet në procesin e transformimeve psikopolitike. Duke qenë për një kohë të gjatë në pushtet, PDK-ja është mishëruar me të dhe ka harruar se si bëhet opozita. PDK-së do t'i duhet kohë për të gjetur pyetjet opozitare, e për të lënë pas trashëgiminë e pyetjes kryesore që është shtruar brenda saj, tash e sa vite: Kush, çfarë merr? Ajo, tani, ndodhet para dy alternativave të veprimit politik: të bëjë një opozitarizëm hakmarrës, ose një opozitarizëm të matur, në kuadër të konsensusit nacional për zgjidhjen e problemit të Kosovës me Serbinë. Sipas gjasave do të provohet me një formulë të ndërmjetme. Në këtë kontekst, LDK ka pozicionin më komod, për shkak se në dy vitet e fundit ajo ka bërë lojë të dyfishtë, duke u përpjekur të ruaj imazhin e një partie konstruktive, por edhe atë të një partie që bën

opozitë efektive. AAK-së, ndërkaq, do t'i duhet një kohë për t'u rehabilituar nga goditja e madhe që mori në zgjedhjet e 6 tetorit. Rënia e përnjëhershme nga entuziazmi i madh në zhgënjimin e madh, ka pasojë traumatike dhe njëra prej tyre mund të jetë dorëheqja e Ramushit nga mandati i deputetit. Për Nismën çfarë të thuhet? Koncepti identitar i saj si një parti e vogël, por e domosdoshme në ndërtimin e qeverive, ka marrë një goditje fatale në zgjedhjet e 6 tetorit. Limaj do të duhet të mendojë për një koncept të ri, nëse ka në plan të vazhdojë të merret me politikë. Madje edhe nëse ndodhë të kalojë pragun, e të futet në qeverinë e re. Partneri i tij parazgjedhor, Pacolli, duket të ketë ardhur në fundin e karrierës së tij politike. Ai mbetet shembull tipik për pafuqinë që pushtetin ekonomik ta shndërroj në autoritet politik. Thënia e famshme e Leninit për politikën si ekonomi e kondensuar, në këtë rast, duket të jetë krejtësisht e gabuar.

## Akademia Diplomatike inauguroi sallën e trajnimeve



EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 TETOR - Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës ka shtuar aktivitetet në fushën e trajnimeve për stafin e ri diplomatik dhe zyrtarët e rinj të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Në këtë drejtim Akademia Diplomatike e Kosovës ka inauguruar sallën e trajnimeve, e cila do t'i shërbejë organizimit të trajnimeve, seminareve e punë-

torive tematike të ndryshme, me qëllim përgatitjen dhe trajnimin e anëtarëve të stafit diplomatik dhe zyrtarëve të tjerë që do të shërbejnë në misionet e Republikës së Kosovës jashtë vendit. Akademia Diplomatike po vazhdon trajnimin intensiv të kontingjentit të diplomatëve të rinj dhe zyrtarëve të rinj të Ministrisë së Punëve të Jashtme, i cili ka për qëllim shtimin e kapaciteteve diplomatike e konsullore për mbrojtjen dhe promovimin e

interesave shtetërore, si dhe forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës. Përveç sallës së trajnimeve, Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës synon të krijojë edhe hapësira të tjera që do t'i plotësojnë nevojat e saj, përfshirë sallën për organizimin e video-konferencave si dhe këndin e bibliotekës i cili do të pajiset me literaturë dhe publikime të fushës së politikës dhe diplomacisë.

## Qalaj, pjesë e konferencës së Asociacionit Ndërkombëtar të Shefave të Policisë

PRISHTINË, 29 TETOR (ER) - Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, është duke qëndruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në një vizitë zyrtare, ku po merr pjesë në konferencën e IACP-së (International Association of Chiefs of Police-Shoqata Ndërkombëtare e Shefave të Policisë). Në konferencën e cila po mbahet në Chicago (26-29 tetor IACP 2019), ku pjesëmarrës janë një numër i madh i nivelit të lartë të shefave të policisë nga vende të ndryshme të botës, me një fjalë rasti të pranishmëve u është drej-

tuar presidenti i ShBA-së, Donald Trump. Kjo konferencë e karakterit ndërkombëtar të pranishmëve iu mundëson shkëmbimin e përvojave policore, trajtimin e problemeve dhe fenomeneve nga fusha e rendit dhe e sigurisë, si dhe njohjen me teknologjitë më të reja të cilat aplikohen në fushën e sigurisë, për shërbime më të mira ndaj të gjitha komuniteteve. Gjatë qëndrimit në ShBA Qalaj realizoi disa takime të rëndësishme, përfshirë takimin me shefin e INL - Department of State, Bureau of International Narcotics and Law Enforcement



Affairs, Principal Deputy Assistant Secretary James A. Walsh, si dhe takim me

ushtruesin e detyrës së drejtorit të ICITAP-it, z. Greg Ducot. Qalaj, përveç të tjerash, gjatë pjesëmarrjes në këtë konferencë si dhe gjatë realizimit të takimeve rëndësi të veçantë i ka kushtuar çështjes së bashkëpunimit policor ndërkombëtar, luftës kundër terrorizmit dhe radikalizimit të dhunshëm, krimit të organizuar transnacional si dhe llojeve të tjera të krimin.

Kjo konferencë e karakterit policor është një nga konferencat më të mëdha të mbajtura çdo vit në ShBA, ku Policia e Kosovës është mbështetur dhe është përkrahur nga ICITAP-i amerikan, të cilët janë bashkëpjesëmarrës.



# Panxha dhe Dema nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi

Rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Marjan Dema, dhe kryetari i Klubit të Prodhuesve të Kosovës, Astrit Panxha, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi i cili ka për qëllim orientimin e studentëve drejt procesit të tregut të punës, respektivisht ekspertizës dhe procesit të prodhimit

**EPOKA E RE**

A. MAVRAJ

**PRISHTINË, 29 TETOR** - Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe Klubi i Prodhuesve të Kosovës kanë nënshkruar të martën memorandum bashkëpunimi i cili ka për qëllim shkëmbimin e informacioneve. Me këtë rast, rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Marjan Dema dhe drejtori ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve, Astrit Panxha, vlerësuan këtë arritje të bashkëpunimit për studentë dhe prodhues të vendit që ka një impakt për zhvillimin ekonomik. Rektori Dema ka deklaruar ky është vetëm edhe një hap në procesin e orientuar drejt tregut të punës. "Ky është vetëm edhe një hap më tutje në procesin e trans-

formimit të Universitetit të Prishtinës nga një universitet që ka qenë më tepër teorik në një universitet të orientuar nga biznesi, nga tregu i punës, bashkëpunimi me komunitetin. Pikërisht në këtë bashkëpunim do të fokusohemi më tepër për shkëmbimin e informacioneve, sepse ne si shoqëri duhet të orientohemi nga informacioni", ka thënë Dema.

Ndërsa Astrit Panxha nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës ka pohuar se sektori i prodhimeve është i ri në Kosovë, ndaj ka nevojë për ekspertizë të reja. Po ashtu, Panxha ka thënë se kjo marrëveshje ndikon pozitivisht në zhvillimin ekonomik të Kosovës "E dimë se sektori i prodhimeve është i ri në Kosovë, kemi nevojë për ekspertizë në aspektin e

kërkimeve të ndryshme. Kemi Fakultetin Elektroteknik, Fakultetin Ekonomik, pra për neve të gjitha këto janë si një burim që duhet ta shfrytëzojmë më shumë. Besoj se bashkëpunimi mes dy organizatave do të krijojë një sinergji për ekonominë e Kosovës", është shprehur Panxha.

Nën organizimin e Klubit të

Prodhuesve sot (e mërkurë) filon ngjarja vjetore treditore Festivali i Gjelbër i cili promovon bizneset e gjelbra të Kosovës dhe nxit interesimin për riciklim, energji të ripërtitshme dhe efikasitet energjetike.

Sektori i gjelbër në rritje e sipër në Kosovë ofron mundësi të konsiderueshme për rritje ekonomike dhe krijim të vendeve

të punës.

Në Festivalin e Gjelbër të vitit të kaluar, 23 ndërmarrje pjesëmarrëse realizuan mbi 1.3 milion euro shitje. Këtë vit, me pjesëmarrjen e 41 ndërmarrjeve kosovare të bazuara në energji të gjelbër që do t'i prezantojnë produktet dhe shërbimet e tyre në festival, priten edhe më shumë kontrata dhe marrëveshje eksporti.

## Sektori jobankar në Kosovë, në trend të mirë të zhvillimit

**PRISHTINË, 29 TETOR (ER)** - Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Inovacionit Financiar të Kosovës (ShIFK), Venhar Hana, ka pritur të martën në takim zyrtarë të lartë të International Finance Cooperation (IFC), Liliana Pozzo dhe Nuria Perez, këshilltare të IFC-së për Regjionin e Amerikës Latine, Evropë dhe Azi Qendrore dhe Partneritet në Inovacion. Në takim Hana ka njoftuar lidhur misionin, qëllimet dhe aktivitetet e ShIFK-së të cilat përfshijnë promovimin e zhvillimit të teknologjisë në sektorin financiar, sikurse edhe nevojën për edukim financiar sa më të

mirë të konsumatorëve në vend. Po ashtu, të pranishmit janë njoftuar lidhur me zhvillimin e industrisë dhe produkteve financiare jobankare të cilat ofrohen nga anëtarët dhe nga tregu në përgjithësi, duke potencuar edhe investimet e huaja në vitet e fundit në industrinë "fintech" në Kosovë. Sipas kësaj komunikate, nga zyrtarët e IFC-së u theksua se sektori financiar jobankar në Kosovë ka kapacitete të mëdha të zhvillimit, veçmas me investimet e huaja të kryera në këtë sektor, sikurse që është me rëndësi të veçantë edhe diversifikimi i produkteve

financiare jobankare të cilat ofrohen nga institucionet financiare në Kosovë.

Gjithashtu, në takim u tha se IFC-ja është e gatshme për ta ofruar ndihmën e saj në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj industrie përmes partneriteteve potenciale.

Zyrtarët e IFC-së, Liliana Pozzo dhe Nuria Perez, për herë të parë vizitojnë Kosovën dhe kanë përvojë të gjatë ndërkombëtare për zhvillimin dhe zbatimin e produkteve financiare duke përdorur kanalet digjitale sikurse telefonat mobilë dhe të ngjashëm.



## Me shumicë votash Kosova votohet si organizatore e punëtorisë MEDS 2021

**PRISHTINË, 29 TETOR (ER)** - Në Bazel të Zvicrës të martën është mbajtur konferenca e koordinatoreve të shteteve anëtare të MEDS (Meeting of Design Students), me ç'rast Kosova u zgjodh si vendi pritës i punëtorisë më të madhe të dizajnit dhe arkitekturës në Evropë për vitin 2021. Në mesin e shteteve konkurruese ishin Kroacia, Gjeorgjia, Armenia dhe Kosova, e cila u shpall e

para.

MEDS (Meeting of Design Students) mbledhë për çdo vit më shumë se 300 studentë të fushave të dizajnit e arkitekturës nga e gjithë Evropa dhe bota.

Në vitin 2021 MEDS do të organizohet në Prishtinë, nga Meds Kosovo, për të bërë ndërhyrje urbane në lagjet e Prishtinës. Kosova merr pjesë në punëtoritë e organizuara nga MEDS që nga viti 2010.





# RAPORTI I INSTITUTIT ZVICERAN PËR R

Gazeta "Epoka e re" në vazhdimë do t'i botojë dy raportet e përkthyer në gjuhën shqipe, njërin prej 44 faqesh dhe tjetrin prej 15 faqesh, të Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës, për rastin e Astrit Deharit. Këto dy raporte tashmë i ka Prokuroria Themelore në Prizren, familja e Astrit Deharit dhe avokati Tomë Gashi. Raporti publikohet pa asnjë ndërhyrje.

- Në nivelin e regjionit frontal superior të djathtë, pjesërisht i mbuluar me flokë, rreth 5,5cm mbi vetullën e djathtë, lëkura është e dëmtuar (ang. "wounded") mbi kate zona, në një sipërfaqe prej rreth 4 cm të diametrit, në një mënyrë relativisht ovale, afër njëra tjetrës, secila ka një diametër ndërmjet 4 dhe 9 mm dhe ngjyrë e kuqe intensive. Lëndime, në karakteristikat e ngjashme, veçanërisht janë të pranishme në nivelin e anës së djathtë të qafës (në afërsi të gërvishitjeve të përshkruara më lart), të aspektit të parregullt, që ishin ndërmjet 3 dhe 7 mm të diametrit; dhe të pjesës së infero-medial dhe të parakrahut të majtë rreth 4 cm mbi gërvishitjet të përshkruara më herët, me orientim boshtor lehtësisht të anuara në boshtin e madh të krahut, në një sipërfaqe prej 40x4mm. Sipas interpretimeve të mjekëve ligjorë, këto lëndime është e mundur se janë shkaktuar gjatë transportimit të trupit, gjatë rianimit mjekësor ose përmes "konvulsioneve" që shoqërojnë obstruksionin e rrugëve ajror gjatë kontaktit me objektin e "skenës së krimt".
- Në nivelin e syve "scrubbing" [shënim i ekspertëve: term që në interpretim si puçrra për shkak të përshkrimeve të ngjashme të përshkruara në nivelin e pleurës parietale në ekzaminimin internë].
- Në rrotullimin e trupit, gjatë autopsisë, përmbytje gjaku rridhin nga vrima e hundës dhe gojës ngjyrë e kuqe e zbehtë, e interpretuar nga mjekët ligjorë se vinte nga edemi pulmonar.
- Një mungesë anomalie në nivelin e mukozës së brendshme të buzëve,
- Në nivelin e këndit mandibular të djathtë, rreth 4 cm të bregut inferior të syrit, një zonë lëkurore e kuqërremtë-trëndafilte, e përshkruar si një "eriteme", ovale, e gjatë 10 x 9mm. Tri zona lëkurore të kuqërremta të nfishme janë të dukshme në nivelin e faqes laterale të ekstremitetit inferior të parakrahut të djathtë, të gjatë 5 x 5mm deri në 12 x 8 mm, afër njëra tjetrës. Sipas interpretimit të mjekëve ligjorë, këto ngjyime të kuqërremta të lëkurës do të mund të ishin provokuar gjatë transportimit ose rianimit mjekësor,
- Në nivelin e anës së djathtë të qafës, rreth 4 cm nën mandibulë dhe rreth 4 cm mbi klavikulën e djathtë, është prania e gërvishitjeve të gjata (ang. "scratches") të lëkurës, gati paralele ndërmjet veti, të orientimit të anuar në krahasim me boshtin e madh të trupit, të kuqe në të trëndafilte, të një gjatësie rreth 7 dhe 9 cm dhe gjerësi 1 deri në 2 mm dhe thellësi rreth 1 mm. Këto lëndime janë ndarë në tri grupe, secili nënkupton 3 dhe 4 plagë. Skajet e këtyre plagëve janë të lëmuara, të rregullta me gjurmë gjaku. Këto lëndime janë interpretua "me besim" (ang. "it can be confidently stated that [...]") nga mjekët ligjorë si lëndime që janë provokuar nga një veprim i një objekti që pret me një teh të hollë i cili ka vepruar në mënyrë tangenciale në nivelin e sipërfaqes së lëkurës,
- Në nivelin e faqes laterale të majtë të toraksit, "shenja të defibrillator",
- Në nivel të kyçit të djathtë (ang. "right hand joint"), shenja të një shpimit venozë duke e lidhur me intervenimin mjekësor,
- Nën bërrylin e majtë tri "signes" [shënim i ekspertëve: term të cilin në nuk e kuptojmë] me ngjyrim vjollce në të përhinte me diametër prej 5 mm që paraqet "sings" [shënim i ekspertëve: sigurisht gabim shtyp, në interpretim këto fjalë si "shenj"] të moçme që nuk korrespondojnë me ngjarjet, sipas mjekëve ligjorë,
- Në nivelin e regjionit inferomedial të kyçit të majtë, tri gërvishitje të gjata, paralele ndërmjet veti, të vendosura në pozita gati horizontale të kuqe, me skaje relativisht të rregullta, të një gjatësie ndërmjet 3 dhe 5 cm, me gjerësi që është rreth 1 dhe 2 cm dhe në thellësi prej 1mm. Këto lëndime janë interpretuar "me besim" (ang. "it can be confidently stated that [...]") nga mjekët ligjorë se janë shkaktuar nga një objekt i ngjashëm me atë që ka provokuar lëndimet e qafës të përshkruar më herët, ose një objekt i ngjashëm.

Në veçojmë elementet e mëposhtme të ekzaminimit intern të trupit të përfshirë në raportin e autopsisë:

- Në nivelin e rrënjës së gjuhës, rreth 5,6 cm nga maja e gjuhës, dy shqyerje (ang. "rips") nga të dy palët e gjuhës, paralele në mes veti, janë 15 x 10 mm dhe 4 mm të thella në të djathtë, të gjata 15 x 8 mm dhe 6 mm thellësi majtas. Sipas interpretimit të mjekëve gjyqësor, këto shqyerje janë shkaktuar nga veprimi mekanik i një instrumenti me përbërje të fortë në momentin e mbylljes të pjesës së thellë të zgavra bukale, për shkak të rezistencës së bërë nga qiellza e fortë,
- Në nivelin e pleurës së organeve të brendshme bilaterale, prani e disa pikave hemorragjike (ang. "drops of hemorrhage") [shënim i ekspertëve: që në interpretim si puçrra] të lokalizuara në veçanti në nivel të sisures (hulli), me një diametër ndërmjet 2 dhe 4 mm. Sipas interpretimit të mjekëve gjyqësor kemi të bëjmë me njolla të Tardieu të interpretuara si shenj karakteristike të vdekjes me asfiksion.
- Një frakturë të brinjës së 4<sup>te</sup> majtas, rreth 3 cm në të majtë të kafazit të krahërorit, pa reagim vital në periferi, i shkaktuar nga matja e rianimit,
- Peshë e trurit është 1650g.
- Një edeme diskrete të parenkimin cerebral,
- Përgatitja e indeve të buta të qafës dhe mungesa e lëndimit të këtyre të fundit,
- Mungesë e lëndimit në zgavrën e gojës,
- Mungesë e lëndimit të kockës hioide (lingual)
- Në nivelin e trakesë dhe të bronkeve kryesore, prani e një sasive të vogël të një substance të kuqe-e lagësht,
- Mushkëritë janë kongjeste, të ënjtura dhe pjesërisht emfizemë. Në prerje dhe në shtypje të parenkimës, rrjedh një substancë mukoze e trëndafilte. Mushkëria e djathtë peshon 850 g dhe mushkëria e majtë peshon 830g,
- Lukthi përmban një substancë të lagësht e përbërë nga mbetjet ushqimore ngjyrë kafe e çelë.

## Histopatologjia :

Raporti i autopsisë zbulon diagnoza histopatologjike si më poshtë.

- Një hemorragji alveolare,
- Një kongestion dhe një edeme akute të mushkërive,
- Prani e materialeve ushqyese në dritën e bronkioleve.

## Toksikologjia:

Raporti i autopsisë zbulon se ekzaminimet toksikologjike të shpejta janë realizuar gjatë autopsisë dhe janë zbuluar negative për 13 substanca (medikamente dhe drogë).

## Shkaku dhe mekanizmi i vdekjes:

Paragrafi për shkaqet dhe mekanizmat e vdekjes raportojnë elementet e mëposhtme:

- Vdekja e z. DEHARI Astrit është rezultat i një asfiksion mekanike përmes obstruksionit të rrugëve respiratorë të epërme me një objekt me përbërje të fortë.
- Mekanizmi i vdekjes mund të shpjgohet si një ndalesë refleksi të punës kardiake (refleksi vaso-vagal) mundësisht i ndihmuar me stimulim të pleksusit nervor të laringut ose të spazmave laringale.
- Lëndimet e përshkruara në pikën 1 dhe 2 [shënim i ekspertëve: pikat 1 dhe 2 referojnë në lëndimet e konstatuara në nivel të kyçit të majtë dhe të qafës; cf. "ekzaminim ekstrin"] janë sigurisht lëndime të vetë-shkaktuara të llojit "hezitim", të shoqëruar me një hemorragji të jashtme por e cila nuk ka provokuar një shok hemorragjik.
- Ekzaminimet toksikologjike të praktikuara deri më tani në përpilimin e raportit të autopsisë janë zbuluar negative për medikamente dhe drogë.

## m. Kartoni i "profil" të mbajtësit DEHARIAstrit, sipas Qendrës së paraburgimit në Prizren, pa datë

- Data e pranimit në qendër të paraburgimit në Prizren: më 1 shtator 2016 në ora 16:00
- I lindur në Berne
- Profesion: student [shënim i ekspertëve: viti i gjashtë i mjekësisë]
- I martuar
- Nacionaliteti: shqiptar
- Feja: Islam
- Gjatësia: 170 cm
- Peshë 76 kg
- Në burg për herë të parë
- I akuzuar: veprimtari terroriste dhe posedim ilegal të armës

Informatat për takimet me drejtorin e burgut:

- "a keni probleme shëndetësore që ne duhet t'i dimë? Po, migrenë"

Informacionet e "Prison Health Department"

- Kualifikimi: "Fakultet Profesion: Mjek" [shënim i ekspertëve: viti i gjashtë i mjekësisë]
- Duhanxhi: Po
- Alkool: Jo
- Sëmundje kronike: jo
- Terapi aktuale: Jo
- Dukja e përgjithshme: e mirë

## n. Raporti mbi gjendjen psikologjike të mbajtësit DEHARI Astrit i dr Shpresa Goqaj më 06 shtator 2016

Dy takime janë zhvillua me z. DEHARI Astrit, i pari më 06 shtator 2016 dhe i dyti më 08 shtator 2016.

Nga këto takime, del se gjendja psikologjike e z. DEHARI Astrit është e mirë dhe stabile. Ai nuk ka histori psikologjike ose psikiatrike as edhe mendime apo tentativa për vetëvrasje në të kaluarën. Gjatë takimeve, ai nuk ka shprehur mendime vetëvrasjeje. Ai tha se nuk konsumon drogë, alkool dhe as duhan. Si moment më të vështirë të jetës së tij, ai përmend humbejn e vëllait të tij. Gjumi dhe apetiti janë të mirë. Ai ka vullnet.

## o. Raporti mbi historinë sociale të z. DEHARI Astrit, sipas Qendrës së paraburgimit në Prizren, pa datë

I mbajturi tregon se banon me gruan e tij dhe se kanë marrëdhënie të mira me prindërit e tij dhe motrën e tij. Ai tregon se posedon një pasuri të patundshme, se ka kushte të mira të banimit dhe hapësirë të mjaftueshme. Situata ekonomike e familjes është e mirë, edhe pse ai nuk tregon prejardhjen e të ardhurave. Ai është i shoqëruarshëm, i arsyeshëm (ang. "rational") dhe se ka shumë miq që janë nga studimet dhe nga organizata. Autoritetet tregojnë se nuk ka pasur veprime penale z. DEHARI Astrit as edhe familja e tij. I mbajturi thotë se ndihet tërësisht i pafajshëm, se arma e gjetur tek ai i takon babait të tij dhe vëllait të ndjerë. Nuk është e vërtetë se ka qenë i implikuar në veprimtaritë për të cilat dyshohet. Pas mbajtjes së tij, ai mendon të kthehet tek familja, studimeve dhe punës së tij.

## Përshtypjet e asistentit social:

I burgosuri duket i hapur, komunikativ dhe i qetë. Tani për tani nuk ka elemente që tregojnë ankthe emocionale as vështirësi të përshtatjes në rrethin r tij. Ai mohon kategorikisht se ka qenë i implikuar në aktivitetet për të cilat qortohet.



# ASTIN E VDEKJES SË ASTRIT DEHARIT

## III. ANALIZA E RE DHE INTERPRETIMET E DISA ELEMENTEVE TË PROCEDURËS NGA CURML

- a. Videot e autopsisë të z. DEHARI Astrit dhe albumet fotografike të autopsisë së z. DEHARI Astrit (të realizuara nga policia e Kosovës)

Ne kemi pranuar 2 DVD dhe 3 CD-ROM që janë :

- 1 DVD që bartë indikacionet 2016-GA-2746 dhe përmban fashikujt e mëposhtëm:
  - o 14 fashikuj video të emëruar M2U00502 në M2U00515
- 1 DVD që bartë indikacionet 2016-GA-2746 dhe përmban fashikujt e mëposhtëm:
  - o 14 fashikuj video të emëruar M2U00513 në M2U00528
- 1 CD-ROM që bartë indikacionet 2016-GA-2746 dhe përmban, në veçanti fashikujt në vazhdim:
  - o 118 fotografi në një dosje të titulluar "Fotot e autopsisë"
- 1 CD-ROM që bartë indikacionet 2016-GA-2746 dhe përmban fashikujt e mëposhtëm:
  - o 16 fashikuj video të emëruar M2U00513 në M2U00528

Regjistrimet video të autopsisë zbulojnë sekuenca të ngjarjeve të mëposhtme :

- Në një sallë të autopsisë njëzet persona rreth një trupi të vendosur në një thes të bardhë të mbyllur, mbi një karrocë metalike,
- Thesi që mbante trupin është zhvendosur mbi tavolinën e autopsisë,
- Thesi është hapur, zbulon trupin e një njeriu (z. DEHARI Astrit). Trupi është i veshur dhe paraqet disa fasha.
- Rrobat dhe lidhjet janë hequr,
- Një ekzaminim i jashtëm i trupit është kryer,
- Kampionet e nën-unguale<sup>1</sup> në nivelin e të dy duarve janë kryer,
- Një ekzaminim dhe fotografi të rrobave janë kryer,
- Një kampion në nivelin e uretrës distale është realizuar,
- Në ekzaminim i brendshëm me :
  - o Autopsi e lëkurës dhe të indeve nën-lëkurore me një prerje vertikale shtrihet në pjesët e sipërme të qafës në simfizë pubike,
  - o Autopsi i rrafshit infra-muskulor
  - o Hapja e koshit të kraharorit në kostotomi
  - o Kampioni i gjakut ekstravazë në gjirin mediastinale anterior pas tërheqjes së plastronit,
  - o Heqja e intestineve,
  - o Kampioni i urinës me gjilpërë,
  - o Kampioni i gjakut në nivelin e enëve iliake me gjilpërë,

<sup>1</sup> E thonjve

- o Vizualizimi i organeve të brendshme në një bllok të vetëm anatomik (metoda e Letulle) mbi tavolinën e autopsisë,
- o Hapja posteriore e faringsit , të ezofagut dhe të lukthit,
- o Kampioni i materialit intra-gastrik,
- o reseksioni i veshkave, shpretkës, gjëndrave adrenale dhe pankreasit, mëlçisë dhe ezofagut,
- o hapja posteriore e laringut dhe e trakeve,
- o ekspozimi i dritës së laringut duke "larguar" nga prapa aparatin kërcor të laringut,
- o reseksioni i mushkrave,
- o reseksioni i zemrës,
- o hapje e kapakut të kokës
- o nxjerrja e encefalonit
- o mbyllja e trupit
- o larja e trupit.

Duke u nisur nga regjistrimet video dhe nga fotografitë e autopsisë, ne vërejmë disa pila që kërkojnë plotësimet dhe modifikimet e mëtejme në krahasim me konstatimet e bëra nga mjekët-ligjorë që kanë kryer autopsinë:

- Në ekzaminimin e jashtëm të trupit:
  - o Në nivelin e regjionit frontal superior, të mesëm dhe paramedian të djathtë, pjesërisht të mbuluar me flokë, i vendosur rreth 4,5 cm mbi vetullën e djathtë, katër pllaka të kuqe pergamene, ovale, afër njëra tjetrës, shtrihen mbi një sipërfaqe rreth 4 cm të boshtit të madh (i përshkruar sikur lëkurë e lënduar (ang. "wounded") në raport të autopsisë),
  - o Në nivelin e konjunktivës bulbar inferior të djathtë, konjunktiva bulbare superiore dhe inferiore të majtë, të konjunktivës palpebral inferior të djathtë dhe konjunktiva palpebrale inferiore e majtë, petechiae (konjunktiva palpebral superiore bilaterale dhe bulbare superiore e djathtë nuk janë në foto); përshkrimi si pika (ang. "drops") hemorragjike në raportin e autopsisë),
  - o Në nivelin e skajit (bregut) anterior-inferior të mandibulës, në të djathtë, e vendosur rreth 2,5 cm nga prapa majës së mjekrës, një eksimozë e kuqe-kafe, ovale, keq e përkufizuar dhe e gjatë rreth 1,7 x 0,8 cm (nuk është përshkruar në raportin e autopsisë).
  - o Në nivelin e regjionit pre-artikular të majtë një dermabrasion i kuqërremtë, linear, horizontal, i gjatë 1 x më pak se 0,1 cm, në afërsi të tre zonave lëkurore të skuqura, me madhësi dhe forma të ndryshme, më e madhja 0,5 cm e boshtit të madh dhe më e vogla nga 0,2 cm të boshtit të madh (të pa përshkruara në raportin e autopsisë),
  - o Në nivelin e regjionit latero-cervikal të djathtë, i vendosur 2,5 cm nën bregun inferior të mandibulës dhe rreth 4 cm mbi klavikulën e djathtë, shumë plagë sipërfaqësore me skaje të pastra, lineare, të pjerrtë poshtë dhe para trupit, të skuqura, gati paralele në mes veti, me gjatësi që mbërrijnë deri në 7 cm (të

përshkruara si gërvishtje (ang. "Scratches") në raportin e autopsisë). Nga këto plagë sipërfaqësore, vërehen gjurmë gjaku të tharë në formë të rrjedhës horizontale,

- o Në nivel të regjionit latero-cervikal të djathtë, të vendosura në pjesën superiore plagë e përshkruara më parë, janë shumë pllaka të holla lineare, pjerrtas të drejtura poshtë dhe përpara trupit, të skuqura, globalisht paralele në mes veti, të një gjatësie që prekin 7cm (të përshkruara si gërvishtje (ang. "scratches") në raportin e autopsisë),
- o Në nivelin e regjionit latero-cervikal të djathtë, i vendosur në nivelin e pjesës më të prapme plagë dhe gërryerje të dermës (dermabrasion) të përshkruara më herët, pllaka të holla të skuqura me trup dhe forma të ndryshme, të predispozura ndemjet veti globalisht në formë të harku të konveksitetit anterior , që janë 3 deri në 7 mm të diametrit (të passhkruara si lëkurë e lënduar (ang. "wounded") në raportin e autopsisë),
- o Në nivelin e regjionit pre-sternal, pektoral i majtë dhe latero-torakali i majtë mavijosje të purpura dhe pllaka lëkura të skuqura me madhësi dhe formë të ndryshme, disa "në formë" (të përshkruara si "shenjat e defibrilatorit" në raportin e autopsisë),
- o Në nivelin e palosjes së bërrylit të djathtë është një aspekt i skuqur dhe i rumbullak i cipës, i rrethuar me një fryrje të kaltës me aspekte të një pike të injeksionit (e përshkruar si shenjë e një injektimi venoz i lidhur me intervenimin mjekësor në nivelin e "right hand joint"),
- o Në nivelin e faqes mediale (në pozitë anatomike) dhe distale të parakrahut të djathtë, tri mavijosje ngjyrë të kuqërremtë, të rumbullakëta dhe pak ovale, keq të kufizuara, më e madhja ishte 2,5 x 1,4 cm dhe më e vogla 0,6 cm të diametrit, prej të cilave dy janë të vendosura në boshtin e njëjtë longitudinal, rreth 0,9 cm njëra nga tjetra dhe e trata është e vendosur proksimale dhe laterale ndaj dy tjerave dhe është 2,5 cm nga më e afërta ( të përshkruara si eritema në raportin e autopsisë),
- o Në nivelin e faqes dorsale të gishtit të tretë të dorës së djathtë, ngjitur me artikulationin metakarpo-falangar, një pikë në të kuqe-kafe, ovale, keq e kufizuar e gjatë 1,5 x 1 cm (e përshkruara si eritema në raportin e autopsisë),
- o Në nivelin e faqes posteriore të bërrylit të majtë tri njolla të purpura, mirë të kufizuara, që maten deri në 0,5 cm të diametrit të një natyre të papërcaktuar (të përshkruara si "signes" në raportin e autopsisë),
- o Në nivelin e faqes anteriore të kyçit të majtë, plagë të shumta sipërfaqësore me skaje të pastra, lineare, horizontale, të skuqura, gati paralele në mes veti, të një gjatësie që arrijnë deri në 3 dhe 5 cm (ang. "scratches" në raportin e autopsisë),
- o Në nivelin e faqes anteriore distale të parakrahut të majtë, rreth 5 cm nën plagët sipërfaqësore të përshkruara më herët, një pllakë e hollë e kuqërremtë, e zgjatur, me gjatësi prej 1 x 0,6 cm, në kontakt me pjesën mediale dhe një cikatrix hipopigmentale, lineare, e pjerrtë e drejtuar në anën e psohtme dhe pak djathtë të trupit e gjatë 2,3 x 0,6 cm ( të përshkruara si lëkurë e dëmtuar (ang. "wounded") në raportin e autopsisë),

- Në ekzaminimin e brendshëm të trupit :

- o Në nivelin e secilit skaje lateral të bazës së gjuhës, një shqyerje lineare, me skaje të pastra, jo hemorragjike, simetrike dhe e gjatë 15 x 10 mm dhe 4 mm e thellë në të djathtë dhe 15 x 8 mm dhe 6 mm e thellë në të majtë (sipas matjeve të realizuara gjatë autopsisë; të përshkruara sikur shqyerje "rips" në raportin e autopsisë),
- o Në nivelin e skajit lateral të djathtë të gjuhës, i vendosur rreth 1,7cm përpara në dilaceration<sup>2</sup> i përshkruar më parë, një dilaceration sipërfaqësor, arciforme<sup>3</sup> me konkavitë superior, i gjatë 1 x 0,2cm (i pa përshkruar në raportin e autopsisë),
- o Në nivelin e pjesës së pasme të rafe<sup>4</sup> së mesme të qiellzës së butë, i vendosur mu përpara në uvule qiellzore një dekolation<sup>5</sup> i kuq-vjollce e mukozës, i zgjatur që evokon një zonë të infiltrimit hemorragjike.
- o Në nivelin e pjesës posteriore paramediale të djathtë të qiellzës së butë, i vendosur rreth 0,4 cm nga dekolation kuq-vjollce të përshkruar më parë, një zonë e dytë dekolation kuq-vjollce e mukozës rreth 0,5 x 0,2 cm, që evokon një zonë të infiltrimit hemorragjik, e vendosur në kontakt me një zonë të dilacertion<sup>6</sup> që mund të korrespondonte me faqe të prerjes të bllokut orofaringal gjatë autopsisë.
- o Petechiae nën pleurë.

## b. Prerja histologjike e autopsisë së z. DEHARI Astrit

Ne kemi pranuar 15 prerje histologjike me ngjyra të hemitoksilinës dhe të cozinës (HE), domethënë :

- 3 prerje që kanë të bëjnë me parenkimën kardiake me indikacionet e mëposhtme :
  - o MA16-286/1 Zemra – H/E
  - o MA16-286/2 Zemra – H/E
  - o MA16-286/2 Koronare – H/E
- 5 prerje që kanë të bëjnë me parenkimën pulmonare me indikacionet e mëposhtme :
  - o MA16-286/3 Mushkëri – H/E
  - o MA16-286/4 Mushkëri – H/E
  - o MA16-286/4 Mushkëri – H/E
  - o MA16-286/4 Mushkëri – H/E
  - o MA16-286/4 Mushkëri – H/E

<sup>2</sup> shkatërrimi i një indit të gjallë me shumë shqyerje të parregullta.

<sup>3</sup> në formë të një harku

<sup>4</sup> Në anatomi paraqet një vijë të formuar përmes kryqëzimit të fibrave që dalin nga dy struktura simetrike.

<sup>5</sup> Pigmentet natyrale të fibrës pastaj ngjyroren, flokët së pari bëhen të kuqe, të verdhë dhe më pas bionde

<sup>6</sup> Veprim për të shqyer dhunshëm, për të ndarë në pjesë një ind organik



Në 30-vjetorin e rënies së Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazliut (1)

# Lëvizja Kombëtare e viteve tetëdhjetë dhe dy heronj të saj, Afrim Zhitia e Fahri Fazliu

**Shkruan: Mehmet HAJRIZI**

Vitet tetëdhjetë të shekullit të kaluar shënojnë sulmin e gjithanshëm, sistematik e mizor të regjimit pushtues serbo-jugosllav kundër Lëvizjes Kombëtare Shqiptare (LKSH), në një rënë anë dhe në anën tjetër, rritjen e zhvillimin e paparë deri atëherë të kësaj Lëvizjeje, në kushte të gjendjeve të jashtëzakonshme, të orëve policore e nëpër barrikada. Këto dy fakte, në aparençë kontradiktore, kanë shpjegimin në dy strategji lufte për jetë a vdekje kundër njëra-tjetrës, shqiptare dhe serbe.

Viti 1981, pas një dekade të lënë pas me veprimtarinë e bujshme të LKSH, me kryengritjen e madhe kundër pushtuesve serbë e jugosllavë, hapi epokën e re të rezistencës së pandalshme e të përhapjes së saj në formë të rrathëve koncentrikë, e cila kulmoi me luftën e armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ndërkaq regjimi pushtues, me gjithë potencialin shtypës ishte mobilizuar, jo vetëm për të asgjësuar çdo vatër çlirimtare në Kosovë, por më tej, për të vënë në zbatim gjithë doktrinën serbe antishqiptare. Serbia është rast i veçantë që armiqësinë e saj ndaj një populli të tërë, siç janë shqiptarët e ka ngritur në doktrinë kombëtare, nëpërmjet të një varg elaboratesh, në funksion të së cilës janë vënë Kisha Ortodokse Serbe, institucionet politike, akademike, informative, kulturore, arsimore, ushtarake, policore, paramilitare etj.

E kishte filluar Garashanini për ta vazhduar Çubriloviçi e Andriçi dhe në kohët më të reja, në shërbim të politikës antishqiptare të Milosheviqit famëkeq u vunë i ashtuquajtur "Libri i kaltër" (1976), Platforma e LKJ për veprim në Kosovë (1981), akademikët, të cilët në vazhdim të traditës së elaboratave shfarosëse, hartuan të ashtuquajturin "Memorandum" (1995), si dokumentin kapak mbi gjithë enën e kuzhinës serbo-madhe, shkrimtarët letërnxirës serbë të "Francuska 7" (1988), kisha dhe shteti, por edhe masat e harlisura qindra

mijëshe e të ashtuquajturve "mitingashë" (1986-1989), pastaj një si elaborat për Kosovën i Partisë Radikale të Sheshelit (1994) etj., të gjitha bashkë, si instrumente, jo vetëm kundër shqiptarëve, por duke e shtuar apetitin ekspansionist edhe ndaj gjithë republikave të Federatës.

Më 1989, Milosheviqi famëkeq, në Gazimestan të Kosovës paralajmëroi luftën e armatosur në Jugosllavi dhe pak vite më pas e ndezi, por u dogj në flakët e saj. Lëvizja Kombëtare Shqiptare e dekadës së nëntë të shekullit të kaluar, pas pagëzimit të zjarrit në kryengritjen e vitit 1981, pati humbje të rënda nga vrasjet dhe dënimet e shumë veprimtarëve, por radhët e saj ripërtëriheshin,

rënëve të lëvizjes më të re kombëtare, bie në sy një lidhje e fortë binjakëzuese midis tandemëve veprimtarë që nuk bënë njëri pa tjetrin, që nuk mund t'i ndante as jeta, as vdekja, që e përplotësonin njëri-tjetrin në mënyrë komplementare dhe që dëshironin të ishin bashkë e të pandarë edhe në sakrificën supreme. Kështu ishte me militantët demonstrues të vitit 1981, Naser Hajrizi dhe Asllan Pireva, me ideologët e shquar të rezistencës, Kadri Zeka dhe Jusuf Gërvalla (1982), me të mëdhenjtë Rexhep Malaj e Nuhi Berisha (1984) që i kthyen pushkë regjimit pushtues, me Afrim Zhitinë e Fahri Fazliun që bënë epopenë e Kodrës së Diellit (1989) etj. Duke

nizuar në revoltën kundër pushtuesit të huaj. Ky shpërthim i ngriti peshë ndjenjat e rinisë së Kosovës, e rriti besimin te energjitë e potenciali kolosal i lirisë dhe e bëri të patundur bindjen për të vazhduar rrugën e pandalshme drejt lirisë e pavarësisë.

Për të kuptuar të vërtetën e shpërthimit të kryengritjes së vitit 1981, do parë parathënien e saj, me shkaqet historike, si statusi prej robi i popullit shqiptar, pozita e rëndë diskriminuese e kolonialiste e tij në bashkësinë e popujve të ish-Jugosllavisë, mjerimi ekonomik e shoqëror, dhuna dhe terrori mbi një popull të tërë etj., si faktorë objektivë, por edhe puna e madhe që kishte

vetëm e Kosovës, por e mbarë kombit shqiptar. Mbi këtë fitore të çimentuar vazhdoi jeta dhe rezistenca në rritje e Lëvizjes Kombëtare deri te Ushtria e lavidhshme Çlirimtare e Kosovës. Gazeta "Boston Globe" e 18 qershorit 1981, pasi konstaton se më 1913 fuqitë e mëdha e bënë Shqipërinë të pavarur, por ia dorëzuan Kosovën monarkisë serbe...", vazhdon: "Kosova është bota e tretë e vogël e Jugosllavisë: e varfër, krenare, e fyer dhe e padurueshme. Mënyra se si do t'ia dalin mbanë pasuesit e Titos kësaj çështjeje do t'i tregojë shumë Jugosllavisë".<sup>4</sup> Komentatorët e huaj parashihnin shpërbërjen e Jugosllavisë për shkak të Kosovës.

Veprimtarët e rinj, Afrim Zhitia e Fahri Fazliu dhe brezi i tyre, e kishin shumë të qartë gjendjen e shqiptarëve nën Jugosllavi, rëndësinë historike të kryengritjes dhe programin idealist kombëtar që duhej ndjekur në vitet vijuese.

3. Midis kryengritjes dhe LKSH ka një lidhje dialektike, prandaj jo vetëm nuk shpjegohet njëra pa tjetrën, por as bëjnë njëra pa tjetrën. Pa kryengritjen Lëvizja do të përfundonte në apati, duke humbur vitalitetin dhe pa Lëvizjen kryengritja as që do të ndodhte. Në themel të të gjitha fitoreve të LKSH qëndron si kurban legjendash, gjaku i bijave dhe bijve më të mirë të saj.

Çështja e harruar e Kosovës, diku në sirtarët e kancelarive botërore, jo vetëm u bë e njohur në botë, por siguroi solidaritet të admirueshëm ndërkombëtar dhe në një mënyrë u shtrua si një problem që donte zgjidhje. Veç shkrimeve afirmative të mediave të botës demokratike, për Kosovën nisën të lëviznin edhe diplomacia e politika ndërkombëtare, duke përfshirë Kongresin Amerikan dhe Parlamentin e Bashkimit Evropian.<sup>5</sup> Duke e pasqyruar panikun jugosllav, propaganda e Beogradit, në një botim të veçantë, me të drejtë konstatonte se ngjarjet e muajve të fundit në Kosovë, hyjnë në zhvillimet më dramatike në historinë më të re të Jugosllavisë.<sup>6</sup> Veli Deva, ish udhëheqës i lartë i Kosovës në Mbledhjen e 86-të të Kryesisë së Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Kosovës, mbajtur më 4 prill 1981 ka thënë: "Pushteti popullor kurrë nuk

**AFRIM ZHITIA**  
1965 - 1989**FAHRI FAZLIU**  
1963 - 1989

duke formuar dhe kalitur veprimtarë të shquar profesionistë dhe me përvojë të gjatë, si Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu.

## Kryengritja e vitit 1981 dhe përpjekjet serbe për zbatimin e doktrinës antishqiptare

1. Fahri Fazliu dhe Afrim Zhitia ishin djem të Llapit kryengritës dhe bedem mbrojtës i Kosovës nga hordhitë serbe ndër shekuj. Fahri i lindur në Llaushë më 1963 dhe Afrimi në fshatin Llugë më 1965, mësimet e para i morën në vendlindje, kurse shkollimin e mesëm në Prishtinë. Shkollimin universitar Afrimi e vazhdoi në Prishtinë, kurse Fahri u aty, por edhe në Zagreb. Sikur shumë dëshmorë të tjerë të kombit edhe këta vinin nga familje të shquara atdhetare.<sup>1</sup> Në vështrim të kronikës së të

shkruar për veprimtarët Fahri Fazliu e Afrim Zhitia dhe lidhjet më shumë se vëllazërore midis tyre, autori Nezir Myrtaj, ka vërejtur një ko incidencë të rastit, por domethënëse, te emrat e tyre. Dy shkronjat e para të emrit Afrim, përbëjnë inicialët: AF (Afrim & Fahri) dhe te emri Fahri: FA (Fahri & Afrim). "Transcendencë e kësaj lidhjeje ndërmjet këtyre dëshmorëve, sikur dëshmon se ata ishin mbështetja dhe njëkohësisht pararoja e njëri-tjetrit deri në rënie"- shkruan autori.<sup>2</sup> Ata ishin një.

2. Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu që në moshë të re, si shkollarë të mesëm hynë në radhët e organizuara atdhetare dhe në radhët e para të demonstruesve të kryengritjes së vitit 1981 në Kosovë. Ata me sytë e tyre në këtë kryengritje panë fuqinë prej uragani të popullit të zgjuar nga letargjia e robit dhe të orga-

bërë LKSH për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve dhe përgatitja e rezistencës së hapur popullore kundër regjimit pushtues, si faktor subjektiv çlirimtar.

Kjo gjendje e shqiptarëve dukej qartë edhe në shifra të statistikave, që siç shkruante studiuesi Marenglen Verli, Kosova "Ndonëse me vetëm 4.2 për qind të sipërfaqes dhe 7.1 për qind të popullsisë, përmbante mbi 10 për qind të të gjitha pasurive natyrore të Jugosllavisë"<sup>3</sup> Por, shfrytëzimi i egër kolonial e kishte katandisur Kosovën në rajonin më të varfër të Jugosllavisë dhe të Evropës.

Lëvizja Kombëtare e vuri nën kontroll kryengritjen, duke dalë në ballë të saj dhe e drejtoi, pa lejuar që të instrumentalizohej dhe të devijohet karakteri i saj. Kryengritja e vitit 1981 me gjithë sakrificat dhe humbjet që pati, ishte një fitore e madhe, jo



është rrezikuar më shumë dhe nuk është luhatur nga një aktivitet më i madh armiqësor sesa që ishte ky aktivitet”.<sup>7</sup> Kurse Kolë Shiroka, koleg i tij, po në këtë mbledhje pranonte: “Pra, planifikimi ka qenë i gjatë dhe kemi të bëjmë me një organizim dhe organizatë më të organizuar sesa organizata jonë”.<sup>8</sup> Duhet thënë këtu që përveç makinerisë shtypëse serbe e jugosllave, mbi trupin e dërmuar të Kosovës peshonte rëndë edhe kolaboracionizmi shqiptar.

Kryengritja e vitit 1981 e lëvizi dhe e ndryshoi historinë, shkroi me gjakun e dëshmorëve vullnetin politik në mënyrë plebishitare të popullit të robëruar shqiptar, duke vrarë frikën dhe shpërfaqti virtytet e larta të sistemit të vlerave tradicionale luftarake, guximin e trimërinë, atdhedashurinë e frymën e sakrificës, vullnetin e hekurt dhe vendosmërinë e patundur për liri dhe pavarësi.<sup>9</sup>

4. Akademiku nationalist serb, Dobrica Qosiq që konsiderohej si baba i kombit serb, pas kryengritjes së vitit 1981, tërthortë konsideronte se që atëherë Kosova i kishte dalë prej dorë Serbisë, prandaj më 26 prill të atij viti shkruante: “Në qoftë se nuk jemi të gatshëm që sërish ta çlirojmë Kosovën, e nuk jemi, duhet ta ndajmë me Shqipërinë. Të merren pjesët serbe dhe manastiret, kurse shqiptarëve t’u lihet ajo që është shqiptare”.<sup>10</sup> Më 1 janar 1996, ai duke analizuar zhvillimet e reja të brendshme, por edhe ndërkombëtare për Kosovën do të vazhdojë: “Kosova është në rendin e ditës të historisë. Po e humbim Kosovën. Por kjo nuk do të jetë fatkeqësi kombëtare. Do të çlirohet Serbia nga ky kancer. Sa më parë aq më mirë”.<sup>11</sup> Por kreu serb i kohës, në stilin “Све или ништа”<sup>12</sup>, e vazhdoi ofensivën kundër Kosovës dhe shqiptarëve.

5. Momenti vendimtar i legalizimit të kësaj ofensive ishte kualifikimi i kryengritjes së vitit 1981 si kundërrevolucion, që në fjalorin politik të socializmit vetadministrues konsiderohej vepra më e rëndë kundër shtetit, prandaj në legjislacionin jugosllav sanksionohej me dënime kapitale. Me qenë se dimensionin e kryengritjes ishte shtrirë në masat revoltuese qindra mijëshe edhe dënimi nuk u kufizua vetëm në LKSH të organizuar, por mbi gjithë popullin shqiptar dhe frontalisht kundër çdo vlere të tij.

Momenti i dytë “legalizues” i revanshit antishqiptar ishte dokumenti i udhëheqjes qendrore të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, me titullin e gjatë dhe fund e krye demagogjik, “Platforma Politike për aksionin e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë në zhvillimin e vetëqeverisjes socialiste, të vël-

lazërim-bashkimit dhe të bashkëjetesës në Kosovë”, miratuar në Mbledhjen XXII të KQ të LKJ-së në Beograd, më 17 nëntor 1981.

Kjo armë e karakterit dhe nivelit jugosllav në duart e krerëve serbë përbente udhëzuesin praktik të zbatimit të politikës antishqiptare në plan imediat dhe afatgjatë, madje në këtë fazë të veprimit, me ndihmën e të gjitha kapaciteteve jugosllave. Në këtë dokument famoz dhe voluminoz, konstatohet për të satën herë se “Kuptimi politik i parullës ‘Kosova-Republikë’ përmban shumë qëllime kundërrevolucionare...se ‘Forcat kundërrevolucionare, në emër të qëllimeve të errëta të nacionalizmit shqiptaromad, u përpoqën që të imponojnë me forcë rebelimin dhe shkëputjen nga Jugosllavia. Ky qëllim kundër-revolucionar, haptazi dhe me zë të lartë, u shpreh me kërkesën e nacionalistëve dhe të irredentistëve shqiptarë që të krijohet e ashtuquajtura ‘Republikë shqiptare’ në Kosovë”.<sup>13</sup> Por qersia mbi tortën e Platformës ishte ky kërcënim i hapur ndaj LKSH dhe kombit shqiptar në përgjithësi: “Kundër armikut do të luftojmë deri në fund vendosmërisht me të gjitha mjetet me të cilat mbrohet siguria dhe integriteti i një vendi të pavarur e të lirë”.<sup>14</sup> “ Afrim Zhitia, i zhgënjyer me qëndrimin e disa përfaqësuesve të Federatës, shkruante: “Federata jugosllave po sillet ndaj Kuvendit serb si prostitutat ndaj myshterit”.<sup>15</sup> (Vijon)

<sup>1</sup> Berat Luzha, *Një histori për Sulë Durmishin*, Prishtinë, 2006 f.103-108

<sup>2</sup> Nezir Myrtaj, *Homazh për flijimtarët*, Prishtinë, 2015, f.20

<sup>3</sup> Marenglen Verli “Shfrytëzimi ekonomik i Kosovës 1970-1990”, Dituria, Tiranë, 1994, f.6

<sup>4</sup> “Shtypi botëror i rreth ngjarjeve në Kosovë”, “8 Nëntori”, Tiranë, 1981

<sup>5</sup> Dr. Jakup Krasniqi, *Lëvizja për Republikën e Kosovës 1981-1991, sipas shtypit shqiptar*, Buzuku, Prishtinë, 2011, f. 20

<sup>6</sup> *Шта се догађало на Косову*, (Çfarë ka ndodhur në Kosovë), Политика, Београд, мај 1981

<sup>7</sup> “Kosova Sot”, 19 nëntor 2006, f. 8

<sup>8</sup> Po aty, 21 nëntor 2006, f. 8,

<sup>9</sup> Mehmet Hajrizi, *Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981*, Toena, Tiranë, 2008

<sup>10</sup> Dobrica Qosiq: *Kosovo*, Novosti, Beograd 2004, f. 30

<sup>11</sup> Po aty, f. 83

<sup>12</sup> Serb. Krejt ose asgjë. <sup>13</sup> Platforma Politike për Aksionin e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë në Zhvillimin e Vetëqeverisjes Socialiste, të Vëllazërim-Bashkimit dhe të Bashkëjetesës në Kosovë. KQ i LKJ-së, Beograd, 17 nëntor 1981, f.23

<sup>14</sup> Po aty, f.42

<sup>15</sup> Adem Gashi, *a-ZH Vetëtimat e Nëntorit*, Prishtinë, 2005 f.191

# Kongresi nesër voton në lidhje me hetimet për shkarkimin e Trumpit

Specialisti i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, Alexander Vindman, ka dëshmuar një ditë pasi kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, njoftoi se vota për të ngritur apo jo akuza kundër presidentit do të zhvillohet nesër (e enjte) në Dhomën e Përfaqësuesve dhe jo në nivel komisionesh

WASHINGTON, 29 TETOR - Ligjvënësit e tri komisioneve të Dhomës së Përfaqësuesve kanë marrë të martën informacion nga një dëshmitar kyç në hetimet që po zhvillohen lidhur me kontaktet e presidentit Trump me udhëheqësin e Ukrainës që mund të çojnë në procesin për shkarkimin e mundshëm të presidentit. Dëshmia e specialistit të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, kolonellejtënant Alexander Vindman, vjen një ditë pasi kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, njoftoi se vota për të ngritur apo jo akuza kundër presidentit do të zhvillohet të enjten në Dhomën e Përfaqësuesve dhe jo në nivel komisionesh.

Ligjvënës të Komisionit të Zbulimit, Punëve të Jashtme dhe të Mbikëqyrjes po dëgjojnë dëshminë e specialistit kryesor për Ukrainën në Këshillin e Sigurisë Kombëtare, ka njoftuar voa. Seanca, e cila u zhvillua me detyrë të mbyllura, konsiderohet si një ndër momentet e rëndësishme në procesin hetimor nëse komunikimet e presidentit Trump me udhëheqësin ukrainas Volodimir Zelenskiy përbëjnë shpërdorim autoriteti dhe abuzim të postit për përfitim personal.

Kolonellejtënant Alexander Vindman, i cili ka shërbyer në radhët e ushtrisë në Irak dhe më pas si diplomat, ka dëshmuar para ligjvënësve se ka dëgjuar bisedën e presidentit Trump me homologun ukrainas më 25 korrik dhe se ia kishte përcjellë shqetësimet konsulentit kryesor ligjor në Këshillin e Sigurisë Kombëtare. “Më shqetësoi telefonata”, shkruan Vindman në dëshminë e përgatitur të martën, të cilën e ka siguruar agjencia e lajmeve “Associated Press”. “Nuk e mendoja se ishte e rregullt t’i kërkosh një qeverie të huaj të hetojë një shtetas amerikan. Më shqetësonin pasojat që mund të

kishte të ndihmat amerikane për Ukrainën”, tha ai.

Presidenti Trump i kishte kërkuar homologut ukrainas të hapte hetime për demokratët dhe rolin e Ukrainës në zgjedhjet e 2016, si dhe mbi kompaninë Burisma, ku shërbente si anëtar i bordit djali i Bidenit, ndërkohë që presidenti kishte ngrirë ndihmat ushtarake për Ukrainën.

Ushtaraku i lartë amerikan Alexander Vindman pati ngritur dy herë shqetësime se administrata Trump po i bënte presion Ukrainës t’i hetonte demokratët dhe ish-nënpresidentin Joe Biden, sipas dëshmisë që ai ka përgatitur të japë para ligjvënësve të martën.

Kolonellejtënant Vindman është zyrtari i parë i Shtëpisë së Bardhë që ka qenë i pranishëm dhe ka dëgjuar telefonatën, i cili po dëshmon në hetimet që mund të çojnë në hapjen e procesit për shkarkimin e presidentit.

Oficeri do të dëshmojë se fillimisht kishte ngritur shqetësime pas një takimi më herët mes ambasadorit amerikan në BE, Gordon Sondland kishte theksuar që Ukraina duhet të hetojë zgjedhjet e 2016-ës dhe kompaninë Burisma, me të cilën kishte lidhja familja kandidatit demokrat për president, Joe Biden.

Në dëshminë e tij, Vindman shkruan se i kishte thënë ambasadorit Sondland se kërkesa për të hetuar Bidenin dhe të birin nuk kishte aspak të bënte me sigurinë kombëtare dhe se Këshilli për Sigurinë Kombëtare nuk do të merrej me çështje të tilla.

Këto deklarata bien ndesh me dëshminë e Sondland, i cili tha para ligjvënësve se “askush nga Këshilli i Sigurisë Kombëtare nuk ngriti shqetësime”.

Kolonellejtënant thotë se edhe për telefonatën e presidentit foli me konsulentin ligjor të Këshillit të Sigurisë Kombëtare për të

shprehur shqetësime për bisedën. “E dija se nëse Ukraina hetonte Bidenin dhe të birin si dhe kompaninë Burisma, mund të interpretohej si manovër partiake dhe pa dyshim do të sillte si rezultat humbjen e mbështetjes dypartiake për Ukrainën. Kjo do të minonte interesat e sigurisë kombëtare për Amerikën”, tha ai.

Para fillimit të seancës, ligjvënësi republikan Jim Jordan theksoi argumentet që kanë ngritur shumë republikanë se komunikimi mes dy presidentëve nuk përbën shkelje të rregullore apo abuzim pushteti. “Njerëzit thonë se sot për herë të parë do të dëgjojmë dëshminë e dikujt që ishte i pranishëm gjatë telefonatës. Kjo s’është e vërtetë. Ky është personi i tretë. Deri tani kemi dëgjuar komentet e presidentit Trump dhe presidentit Zelenskiy. Faktet themelore nuk kanë ndryshuar ndonjëherë. Kemi dëgjuar opinionet e ndryshme por faktet mbeten ato. Nuk ka pasur presion, nuk ka pasur kërkesë për shkëmbim favoresh. Kemi dëgjuar presidentin Trump dhe presidentin Zelenskiy se nuk ka pasur imponim, nuk janë vënë kushte”, tha ai. Vindman është një ndër dëshmitarët më të rëndësishëm. Ai shkruan se është patriot dhe në veprimet e tij është nxitur nga ndjenja e përgjegjësisë për të mbrojtur vendin, jashtë intereseve partiake.

Dëshmia e tij pason njoftimin të hënën të kryetares së Dhomës së Përfaqësuesve Nancy Pelosi se të enjten e gjithë Dhoma e Përfaqësuesve do të votojë mbi një rezolutë për të afirmuar hetimet që mund të çojnë në procesin për shkarkimin e mundshëm të presidentit. Rezoluta gjithashtu specifikon rregulloret për seancat publike me dëshmi si dhe shpjegon procesin për hartimin e akuzave për procesin e shkarkimit të mundshëm.





**E rrallë**

## U bë kasape pasi hëngri hamburger

Një grua që jetonte si vegetariane prej 10 vjetësh vendosi të bëhej kasape. Ideja i erdhi pasi mbeti shtatzënë për herë të tretë dhe filloi të hante mish sërish. Tammi Jonas, 49-vjeçare, u bë vegetariane në vitet 1970 kur lexoi librin e Peter Singer "Animal Liberation" dhe u shokua nga keqtrajtimi që u bëhej kafshëve. Për një dekadë, dieta e saj ushqimore ishte vegetariane, por gjithçka ndryshoi kur do të bëhej nënë për herë të tretë.



**FOTO E DITES**



Një burrë shihet ulur në zonën rrjedhëse të lumenjve Ganges në Sangamit. /AFP/

**E jashtëzakonshme**

## Burri me kancer fiton 200 000 dollarë në lotari ditën e fundit të kimioterapisë

Një burrë që vuan nga kanceri i zorrës së trashë fitoi 200 000 dollarë në lotari në ditën e tij të fundit të kimioterapisë. Ronnie Foster nga Karolina e Veriut e bleu lotarinë për një dollarë në një pikë karburanti në Beulaville javën e kaluar. Ai fitoi pesë dollarë dhe vendosi që këto para t'i shpenzonte për blerjen e një tjetër bilete. Me lotarinë e dytë fitoi plot 200 000 dollarë.



**BARSOLETA E DITËS**



Një grua shkon te farmacisti dhe i thotë: - Ju lutem më jepni një dozë arsenik.  
Farmacisti: - Për çfarë ju duhet?  
Gruaja: - Dua ta helmoj burrin.  
Farmacisti: - Nuk japim ilaçe të tilla.  
Gruaja i tregon një fotografi që burri i saj kishte dalë me gruan e farmacistit.  
Farmacisti: - Pse nuk më the që në fillim se e kishte recetën?!



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Vetem gjatë vikendit në ora

14:00

### ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.  
Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

### TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min



Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.  
Regjia: Josh Cooley

Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

### MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.  
Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

### ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), **fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Ju mund të ndiheni sikur nuk keni asnjë vend ku mund shkoni.</p>	 <p><b>DEMI</b> Ju keni shumë vetëbesim. Arrini të përballeni mirë me situatat e vështira dhe nuk lejoni t'ju kapë paniku.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Mund të ndiheni si ndërmjetës midis dy kampeve, ose mund të jeni në një debat që ka nevojë për ndërmjetësim.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Jini të kujdesshëm që të mos merrni çdo koment në aspektin negativ.</p>	 <p><b>LUANI</b> Mund të keni shumë tension dhe pyesni veten përse askush nuk po i përgjigjet punës së tij.</p>	 <p><b>VIRGJËRRESHA</b> Tensioni mund të lindë mes miqve kur dikush të ndihet si personi i tretë i panevojshëm në grup.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Me kalimin e kohës nevoja për dije botërore dhe zhvillimin e njerëzimit është bërë më e dukshme për ju.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Vetëm kur ngadalësoni, thjeshtëzoni dhe planifikoni, gjërat fillojnë të punojnë përsëri.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Dëshira juaj për të luajtur mund t'ju fusë në telashe. Kështu që sot kujdes me lojën se mund ta teproni. Vendosini kufi.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Veglat dhe pajisjet e reja që supozohet se e bëjnë më të lehtë pëmbushjen e detyrave të caktuara mund të shkaktojnë më shumë punë dhe konfuzion.</p>	 <p><b>UJORI</b> Jini të kujdesshëm nëse doni të bëni sarkazëm.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Kohët e fundit ndoshta keni pikturuar një pamje të rremë të vetvetes.</p>



## David dhe Lily zyrtarizojnë lidhjen edhe në 'Instagram'



**D**avid Harbour dhe Lily Allen e kanë zyrtarizuar lidhjen në 'Instagram'. Aktori 44-vjeçar dhe artistja 34-vjeçare pozuan së bashku dhe imazhi u postua në 'Instagram'. "Princi, princesha dhe vendparkimi", ka shkruar Davidi

poshtë fotografisë. David Harbour dhe Lily Allen janë lidhur që nga fillimi i gushtit kur edhe u panë bashkë në Londër, Angli dhe së fundmi bënë debutimin e tyre në tapetin e kuq në Champions of Change Gala.

## Justin Bieber nxjerr albumin me një kusht



**J**ustin Bieber ka lënë të kuptohet se këngë të reja do të vijnë së shpejti nga ai. Por, kjo do të bëhet vetëm në rast se një postim i tij i fundit merr 20 milionë pëlqime. "Nëse kjo merr 20 milionë pëlqime,

Justin Bieber do të nxjerrë një album para Krishtlindjeve", ka shkruar ai në "Instagram". Natyrisht, pëlqimet erdhën pa hezituar. Në më pak se 24 orë këngëtari tashmë kishte mbledhur gati shtatë milionë pëlqime.



## Rikthehet seriali "Friends"?

**A**ktorja e njohur Jennifer Aniston ka qenë e ftuar në programin e Ellen DeGeneres ku, ndër të tjera, është pyetur edhe për një rikthim të serialit ikonik "Friends". Anistoni ka theksuar se nuk i dihet se çfarë

mund të rezervojë e ardhmja, duke u treguar pozitive për një rikthim. "Ne do të donim të bënim diçka, por nuk e dimë ende konkretisht se çfarë. Por, po provojmë diçka të gjithë, po punojmë të gjithë për diçka", ka përfunduar ajo.

## Ben Affleck nuk është në lidhje me Katie Cherryn



**B**en Affleck ka qenë në lidhje të ndryshme përgjatë viteve të fundit, por nuk është në një marrëdhënie me Katie Cherry pavarësisht prej thashethemeve. Aktori 47-vjeçar u pa me Katien në një festë për Halloween gjatë

fundjavës. "Us Weekly" raporton se Ben dhe Katie u takuan disa muaj më parë dhe që atëherë kanë krijuar një 'lidhje' me njëri-tjetrin. Por, një burim i afërt me aktorin ka thënë se nuk ka asgjë të vërtetë sa i përket një lidhjeje mes tij dhe Katies.



# Shqiptarët që sunduan

Është e shpeshtë shprehja se shqiptarët janë dëshmuar më shumë jashtë atdheut. Këtë e dëshmon edhe familja Gjika, që ka sunduar në Rumani, nga shekulli XVII.

Me origjinë ilire ishin afro 30 perandorë romakë dhe së paku gjashtë të Bizantit. Madje, mendohet se edhe dinastia e maqedonasve, komnenëve, dukasëve, paleologëve dhe katakuzhinëve ishin të afërt me shqiptarët. Përmendet shpesh se si shqiptarët kanë dhënë kontribut të madh edhe në Perandorinë Otomane. Në këtë perandori numërohen jo pak se 39 kryeministra me origjinë shqiptare. Ndërsa, një shqiptare ishte Valide Sulltane - nëna e sulltan Mehmeti të III-të. Po ashtu, ishte një dinasti sundimtarësh në Egjipt, që nga fillimi i shekullit XIX e deri më 1953; katër Papë të Kishës Katolike ishin nga këto troje; e me origjinë shqiptare ishte edhe dinastia mbretërore e Serbisë: Karagjorgjët!

Por, ajo që dihet pak është se edhe me Moldavinë dhe Vllahinë (toka rumune) kanë sunduar princërit me origjinë shqiptare: familja Gjika. Që nga shekulli XVII-të, ata dhanë një seri e shkëlqyeshme të përfaqësuesve, të elitës që mbulonin një gamë të gjerë sociale. Nga kjo familje dolën vojvodë, dinjitarë, ministra, politikanë, diplomatë, ushtarakë dhe personalitete fetare, e deri tek shkencëtarët dhe personalitete të kulturës, dashamirë të arteve të bukura dhe të bukurisë. Vepruan jashtë atdheut, por nuk e harruan atë kurrë, sepse sa herë që ju dha rasti, treguan origjinën e tyre shqiptare pa asnjë ngurrim. Është fakt që Gjikajt kanë origjinë shqiptare dhe që

shpesh dëgjohej të thuhet se kanë ardhur nga Maqedonia, më saktësisht nga Jugu i Shkupit, Velezi, që është quajtur edhe Köprülü - emër i themeluesit të një familjeje të madhe fisnike të vezirëve të mëdhenj osmanë (familja e Qyprillinjve që dhanë gjashtë vezirë dhe e dërguan Perandorinë Otomane deri në dyert e Vjenës), që në njëfarë mënyre i ndihmoi Gjikajt të ngjiteshin në rangjet e larta shoqërore.

Familja Gjika sundoi në Vllahi dhe Moldavi. Emrat e princërve janë si më poshtë:

#### Princërit e Vllahisë:

Gheorghe Gjika (1659-1660 dhe 1673-1678)  
Grigore I Gjika (1660-1664 dhe 1672-1673)  
Grigore II Gjika (1733-1735 dhe 1748-1752)  
Matei Gjika (1752-1753)  
Scarlat Gjika (1758-1761 dhe 1765-1766)  
Alexandru Gjika (1766-1768)  
Grigore III Gjika (1768-1769)  
Grigore IV Gjika (1822-1828)  
Alexandru II Gjika (1834-1842)

#### Princërit e Moldavisë:

Gheorghe Gjika (1658-1659, 1735-1741 dhe 1747-1748)  
Matei Gjika (1753-1756)  
Scarlat Gjika (1757-1758)  
Grigore III Gjika (1764-1767 dhe 1774-1777)  
Grigore V Gjika (1849-1853 dhe 1854-1856)

Nga kjo familje rrjedh edhe Elena Gjika (1828-1888, e njohur me pseudonimin Dora d'Istria), shkrimtare, publicistë dhe feministe, që u radhit në mesin e dhjetë 10 femrave më të ngritura intelektualisht në atë kohë, e që përkrahu Rilindjen



Pallati i familjes Gjika në Komaneshti të Rumanisë

Kombëtare Shqiptare, duke mbajtur lidhje të ngushta me veprimtarë të shquar të saj, si: Jeronim de Rada, Dhimitër Kamarda, Zef Jubani, Zef Serembe, Thimi Mitko etj.

Po ashtu, nga kjo familje ishte Albert Gjika (1868-1928), pretendenti i fronit të Shqipërisë, që mbështeti kauzën kombëtare shqiptare, e sidomos shoqatat shqiptare në Rumani. Motoja e tij ishte "Shqipëria për shqip-

tarët", ndërsa ishte zgjedhur nga Komiteti i agjitacionit të Shqipërisë si "prijësi kryesor për pavarësinë e shqiptarëve". Studiuesi Ismail Ismaili ka analizuar veprimtarinë e Albert Gjikas dhe ka përkthyer shumë dokumente që ndërlidhen me



emrin e tij dhe kauzën kombëtare shqiptare. Ai, në deklaratat e tij të kohës, thotë se shqiptarët janë pellazgë, pasardhës të maqedonasve të lashtë, të Filipit dhe Lekës të Madh. "Pesë vilajetet, i Shkodrës, Janinës, Kosovës, Manastirit dhe Selan-ikut përbëjnë mbretërinë e vjetër të Shqipërisë dhe shqiptarët nuk dëgjojnë fare për copëtimin e atdheut të tyre. Ata janë treguar kundërshtarë të të gjitha invadimeve sllave që kanë për qëllim vetëm bullgarizimin e territorit të tyre", ka thënë ai, sipas studiuesit Ismaili, duke kundërshtuar

politikat e fqinjëve që bëheshin gati të pushtonin trojet shqiptare.

"Vilajeti i Selanikut dhe i Manastirit janë të banuar me një popullatë shqiptare dhe nuk është e vërtetë se ekzistojnë 400 mijë sllavë që jetojnë aty dhe të cilët kanë aspirata që ta aneksojnë pjesën më të madhe të këtij territori. Në Greqi ka shumë shqiptarë, përafërsisht një milion, dhe ky fakt nuk e ndaloj Greqinë që ta shpallte pavarësinë. Unë personalisht i kam komanduar trupat për pavarësi të cilat u përforcuan edhe me dymbëdhjetë mijë vullnetarë evropianë; ne kemi gjithçka që na duhet për të luftuar dhe nuk kërkojnë dhe as më të voglën gjë për ta fituar lirinë tonë dhe nëse është nevoja do të vdesim të gjithë për të", ka thënë po ashtu Gjika, duke kundërshtuar gjithnjë statistikën e rrëshme të fqinjëve, për popullatën shqiptare dhe duke thënë se sllavët nuk janë gjë tjetër pos element nomad, pa pasuri, por që është pranuar për punë krahu.

Ismaili e ka gati një libër për Albert Gjiken. Më poshtë ju sjell një letër të tij të botuar në mediat e kohës më 1904, ku shpreh pikëpamjet e tij për Shqipërinë dhe shqiptarët.



Familja Gjika



# Rumaninë



"Kreu i lëvizjes për pavarësi paraqet politikën e tij

## SHQIPËRIA E SHQIPTARËVE

Familja e tij është e njohur për vice guvernatorët e Principatave të Danubit

Zotëri kryeredaktor:

Më datën 14 shtator 1904, të gjitha gazetët e mëdha evropiane kanë botuar notën e më poshtme të dërguar nga Budapesti:

"Sferat diplomatike austro-hungareze e kanë komentuar zëshëm lajmin e ri të ardhur nga Vjena dhe Budapesti se Princi rumun, Albert Gjika, dëshiron të vihet në krye të lëvizjes autonomiste shqiptare.

Ky person dëfton se është me origjinë shqiptare; prandaj të parët e tij kanë qenë të emëruar gospodarë ose princa të Vllahisë, nga Porta e Lartë, pasi që rridhnin nga fisnikët fanaritë, çfarë do të thotë, grekë, të Konstatinopojës. Edhe pse Princi Gjika deklaroi tashmë se puna e tij do të jetë e lidhur me veprimtarinë e cila ka të bëjë me vendosjen e paqes, si dhe kjo veprimtari synon vendosjen e një rendi afatgjatë në rajonet perëndimore të Ballkanit, që shpesh janë të përfshira nga trazirat, ne më së paku mendojmë këtu se hyrja e një pretenduesi të ri në skenën e garave shqiptare, do të rrisë më tej konfuzionin dhe çrregullimet në këtë vend që

Shqipërisë si pasardhës i Skënderbeut të famshëm".

Pasi që u njoftuam me këtë notë që tani, po ngarendi që t'ua jap detajet të cilat m'i keni kërkuar dhe ju lus t'i futni në gazetën tuaj të çmuar, por edhe korigjimet e nevojshme të disa citimeve fyese për të kaluarën e të parëve të mi dhe ndriçimet që lidhen me misionin tim. Kam pasur nderin të jem i emëruar në krye të lëvizjes për pavarësi shqiptare dhe njëherësh falënderoj patriotët të cilët patën besim në mua duke ma lënë kauzën e tyre të drejtë në duart e mia. Pas shpjegimit të çështjes së pretenduesve fantazistë dhe pas pranimit të deklaratës së shkruar të delegatëve shqiptarë, unë pranova këtë detyrë delikate e cila tashmë është e ligjshme. Familja princore e Gjikasve është shqiptare dhe Turqia e dërgoi për të sunduar në principatat e Moldo-Vllahisë në vitin 1856.

Lartmadhërisë së tij, princit Gregori III Gjika, iu pre koka më 1777, pasi kundërshtoi shitjen e Bukovinës Austrisë; kjo është një provë flagrante që tregon origjinën shqiptare të të parëve të mi, i cili nuk do të reagonte në këtë mënyrë sikur të ishte fanarit ose grek. Që atëherë, Gjikasjt kanë sunduar për vite të tëra në principatat danubiane dhe administrimi i tyre i mençur, ishte njëra nga bazat e krijimit të mbretërisë së Rumanisë. Kështu, pasi që u bënë princër trashëgimtarë të Perandorisë së shenjt gjermane, princër të mbretërisë ruse, Gjikasjt kanë të drejtë për titullin e altes serenissime.

Pas këtyre shpjegimeve, do të shtoja se programi im paqësor ka për qëllim të sjell paqen dhe paj-

timin në mes shqiptarëve, kutzovllehve, bullgarëve, serbëve dhe grekëve, pa asnjë dallim feje.

"Shqipëria shqiptarëve", kjo është deviza ime dhe të gjithë ata që jetojnë në territorin e Shqipërisë, janë fëmijë të saj. Asnjë aneksim i Shqipërisë nuk do të jetë i mundur. E tërë Evropa do të jetë fajtoare për padrejtësinë dhe për krimin kundër njerëzve, nëse ajo do të dëshironte t'i favorizojë pretendimet e cilës do fuqi qoftë ajo. Shqiptarët kanë rezistuar më forcë kundër ekzekutimit të Traktatit të Berlinit të 1878-ës. Do të duhej të masakroheshin deri në të fundit, tani në vitin 1904, nëse dikush mësyn për ta pushtuar atdheun e tyre.

Populli shqiptar, i lirë dhe i pavarur do t'ua dhurojë kurorën më të denjëve dhe unë do të jem i pari që do të përkulet para të zgjedhurit të kombit.

Pranoi, Zotëri kryeredaktor, konsideratat e mia më të larta.

### PRINCI ALBART GJIKA" (përktheu Ismail Ismaili)

Princi Albert më vonë e kishte kthyer në shqip mbiemrin e tij, nga Ghica në Gjika, edhe pse sipas disa gazetarëve të kohës ai nuk e dinte asnjë fjalë shqip. Por, nuk ia doli të sundojë me shqiptarët. Më vonë, ai madje heq dorë nga kjo, siç dëshmohej nga letrat e studiuesit dhe mikut të madh të shqiptarëve, që po ashtu ishte pretendent për fronin shqiptar, Franz Nopcsa von Fels?-Szilvás. Albert Gjika vdiq më 1928, në moshën 60-vjeçare. Shumë historianë rumunë, synojnë ta mohojnë origjinën shqiptare të kësaj familje të fuqishme, e sidomos përkufizimin që e ka dhënë vetë Elena Gjika në veprën e saj, "Shqiptarët në Ruman". Por, janë vetë anëtarët e kësaj familjeje që origjinën shqiptare nuk e kanë mohuar.



Nga e majta në të djathtë: George Gjika Voda Gjika i I-rë, Grigori I Gjika Voda Gjika i II-të, Grigori II Gjika Voda Gjika i III-të, Matea Gjika Voda Gjika i IV-të, Skarlat Gjika Voda Gjika i V-të



Nga e majta në të djathtë: Grigori III Gjika Voda Gjika i VI-të, Aleksandër I Gjika Voda i VII-të, Grigori IV Gjika Voda Gjika i VIII-të, Aleksandër II Gjika Voda Gjika i IX-të, Grigor V Gjika Voda Gjika i X-të

**PRINCE GHICA AND FREE ALBANIA.**

**Head of the Movement for Independence Expounds His Policy.**

**ALBANIA FOR THE ALBANIANS.**

**His Family Long Famed for Their Wise Government of the Danube Principalities.**

MONSIEUR LE REDACTEUR EN-CHIEF:

A la date du 14 septembre 1904, tous les grands journaux européens reproduisaient la note suivante transmise de Budapest:

"Les sphères diplomatiques austro-hongroises commentent vivement la nouvelle récemment arrivée à Vienne et à Budapest que le prince roumain Albert Ghika veut se mettre à la tête du mouvement autonomiste albanais.

"Ce personnage assure être d'origine albanaise; pourtant ses ancêtres furent nommés hospodars ou princes de Valachie par la Sublime Porte, comme appartenant à la noblesse phanariote, c'est à dire, grecque, de Constantinople.

"Bien que le Prince Ghika déclare d'ores et déjà que son œuvre sera une œuvre de paix, puisqu'elle vise l'établissement d'un ordre durable dans les régions occidentales, si souvent troublées, de la péninsule Balkanique, l'on n'en pense pas moins ici que l'entrée d'un nouveau prétendant sur la scène des compétitions albanaises accroîtra encore la confusion et le désordre dans cette contrée si intéressante pour l'Autriche-Hongrie.

"Que quel qu'il soit, il serait certainement erroné, et même important, de savoir si le prince Ghika est un auxiliaire ou bien un concurrent du diplomate espagnol, Don Juan d'Aladro Castrioti qui fit tant parler de lui il y a trois ans en revendiquant le trône d'Albanie comme descendant du fameux Scander Beg."

N'ayant pris connaissance de cette note que maintenant, je m'empresse de vous donner les détails que vous me demandez, et que je vous prie d'insérer dans votre estimé journal, avec les rectifications nécessaires à certaines allégations insultantes pour le mémoire de mes ancêtres et l'éclaircissement de ma personne.

J'ai eu l'honneur d'être nommé chef suprême du mouvement pour l'indépendance albanaise, et je remercie les patriotes qui ont eu confiance en moi, en me remettant leur juste cause entre les mains.

Après avoir élucidé la question des prétendants fantaisistes et reçu les déclarations écrites des délégués albanais, j'ai accepté la tâche délicate que me revenait de droit.

La famille princière des Ghica est albanaise, et la Turquie l'envoya pour régner sur les principautés de Moldo-Valachie en 1856.

Son Altesse le prince Grégoire III Ghica fut décapité en 1777, pour s'être opposé à la cession de la Bucovine à l'Autriche; c'est la preuve flagrante de l'origine albanaise de mon ancêtre, qui n'eut pas agi de même s'il avait été phanariote ou grec.

Depuis, les Ghica ont régné pendant de longues années sur les principautés danubiennes, et leur sage administration a été l'une des bases de l'édification du royaume de Roumanie.

Créés princes héréditaires du Saint-Empire d'Allemagne, princes de l'Empire Russe, les Ghica ont droit au titre d'Altesse sérénissime.

Ceci dit, j'ajouterais que mon programme est un programme pacificateur destiné à apporter la paix et la concorde entre Albanais, Koutzo-Valaques, Bulgares, Serbes et Grecs sans aucune différence de religion.

"L'Albanie aux Albanais," voilà ma devise, et sont enfants d'Albanie tous ceux qui vivent sur son territoire.

Aucune annexion de l'Albanie ne pouvant être possible, l'Europe entière se rendrait coupable d'une injustice et d'un crime contre le droit des gens si elle voulait favoriser les prétentions d'une puissance quelconque. Les Albanais ont résisté victorieusement à l'exécution du traité de Berlin en 1878, il faudrait les massacrer pour qu'ils cessent en 1904 pour sembler de la partie.

Le peuple albanais, libre et indépendant, offrira au monde au plus digne, et je serai le premier à m'incliner devant l'élu de la nation.

Agissez, Monsieur le Rédacteur en Chef, l'assurance de ma haute considération.

**PRINCE ALBERT GHICA.**

Pushteti i Gjikasve bie pas bashkimit të Vllahisë dhe Moldavisë, nën sundimtarin Alexander Ioan Cuza, që po ashtu dyshohet se ishte shqiptar, meqë origjina e tij përmendej të jetë nga fanariotët e Stambollit. /Telegrafi/



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Berisha: Suksesi, falë presidentit Arsim Kabashi

Kapiteni Visar Berisha për "Epokën e re" ka thënë se sukcesi i Ballkanit është falë punës së palodhshme të presidentit të klubit, Arsim Kabashi. "Në këtë edicion jemi duke kaluar nëpër një formë të mirë. Çelësi kryesor i suksesit të deritashëm është falë organizimit të mirëfilltë të klubit si dhe punës së palodhshme të presidentit Arsim Kabashi", ka thënë Berisha. Ballkani është lider i elitës. Ndeshjen e radhës e zhvillon ndaj Feronikelit



**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 29 TETOR** - Skuadra e Ballkanit në edicionin e kaluar mezi e siguroi mbetjen në IPKO Superligë me 43 pikë, vetëm një pikë më shumë se Trepça '89 që është dashur të luajë në barazh për ta siguruar mbijetesën. Në këtë edicion gjërat janë krejtësisht ndryshe, sepse klubi nga Suhareka e ka fjalën kryesore pas dymbëdhjetë xhirove të zhvilluara në Superligë dhe aktualisht është lider. Redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re" e ka kontaktuar të martën kapitenin Visar Berisha, i cili ka thënë se organizimi i mirëfilltë dhe puna e presidentit të klubit, Arsim Kabashi, i ka sjellë këto rezultate. "Në këtë edicion jemi duke kaluar nëpër një formë të mirë. Çelësi kryesor i suksesit të deritashëm është falë organizimit të mirëfilltë të klubit si dhe punës së palodhshme të presidentit Arsim Kabashi", ka thënë Berisha. Më pas kapiteni i skuadrës së Ballkanit foli edhe për ndeshjen derbi që e zhvillo-

jnë në fundjavë ndaj Feronikelit. Në ndeshjen e parë Ballkani kishte fituar 3-1, kurse tash Berisha nuk jep ndonjë parashikim për rezultatin final, por ka lënë të nënkuptohet se skuadra e drejtuar nga Ismet Munishi në secilën ndeshje e kërkon maksimumin e pikëve. "Aktualisht jemi liderë falë formës, disiplinës dhe harmonizimit të mirë të ekipit. Çdo ndeshjeje i qasemi me përkushtim maksimal. Kjo ka bërë që ne tani të jemi më lart se ekipet e tjera. Edhe ndeshjen e radhës do ta marrim me përkushtim maksimal dhe do t'i qasemi ashtu si ndeshjeve të tjera", ka shtuar Berisha. Mbrojtësi me përvojë të madhe edhe përkundër moshës është duke shkëlqyer në këtë kampionat. Ai është një nga pikat më të forta në skuadrën e Ballkanit dhe në fund mund të jetë ai që mund të ngrehë lart trofeun e kampionit, pse jo edhe të Kupës. Lidhur me sukseset e skuadrës së tij, Berisha tregohet i kujdesshëm, duke thënë se është herët për ta parashikuar përfundimin e kam-

pionatit. "Me gjithë formën që e gëzojmë si ekip, por edhe personalisht, mendoj se është ende herët për të folur për trofetë që mund të fitojmë. Ne jemi në rrugë shumë të mirë, por kampionati është shumë i gjatë dhe ka ende lojë për t'u zhvilluar", ka përfunduar ai. Ballkani aktualisht është në pozitën e parë në elitë me 26 pikë. Prej dymbëdhjetëve ndeshje, ka regjistruar tetë fitore, dy humbje dhe dy barazime.

## IPKO SUPERLIGA - Java e 13

**Të premtën takohen:**  
13:00 Llapi - Drenica

**Të shtunën takohen:**  
13:00 Trepça '89 - Vushtrria  
13:00 Feronikeli - Ballkani  
13:00 Dukagjini - Prishtina

**Të dielën takohen:**  
13:00 Gjilani - Ferizaj  
13:00 Flamurtari - Drita

## SHKURT

### Khaka merr 'goditjen' e parë nga Arsenal

Mesfushori Granit Xhaka është një nga lojtarët më të përfolur në Angli për shkak të episodeve që ndodhën gjatë zëvendësimit të tij në ndeshjen ndaj Crystal Palaces. Në drejtim të shqiptarit gjatë zëvendësimit kishte fishkëllima të shumta nga tifozët, me lojtarin që nuk u përmbajt, por me ironi ua bëri më shenjë atyre të fishkëllejnë më shumë, duke u larguar menjëherë në drejtim të dhomave të zhveshjes. Trajneri Unai Emery u shpreh i pakënaqur për këtë gjest të futbollistit, për të cilin paralajmëroi se do të merren masa. Pikërisht masa e parë ka ardhur të martën teksa trajneri vendosi që të jashtë listës me lojtarët e ftuar për ndeshjen ndaj Liverpoolit, e cila zhvillohet të mërkurën në kuadër të 1/8 së Kupës. Xhaka rrezikon ta humbë edhe shiritin e kapitenit, i cili iu besua vetëm pak kohë më parë.

### Kemal Ademi përjashton Shqipërinë, por jo Kosovën

Kemal Ademi është një nga sulmuesit që ka bërë më tepër jehonë deri tani te Bazeli. Sulmuesi në një intervistë për "BZ Basel" e ka përjashtuar mundësinë për të luajtur për Shqipërinë, por jo edhe për Kosovën. "Janë tri mundësi për të shkuar te Gjermania, Kosova apo Zvicra. Menaxheri im është në kontakt me to. Por unë nuk kam asnjë stres dhe jam i përqendruar te Bazeli. Do të vijë gjithçka me kohën", ka thënë Ademi.

### Dënohet Bullgaria

Bullgaria është urdhëruar të luajë dy ndeshje pa tifozë, njëherën nga to të pezulluar si vendim për dy vjet dhe është gjobitur me 75 mijë euro për shkak të sjelljes raciste të tifozëve në ndeshjen me Anglinë në Eliminatorët për "Euro 2020". Federata e Futbollit në Bullgari është gjobitur edhe me 10 mijë euro për shkak të pengesave gjatë intonimit të himnit dhe do t'i duhet ta mbajë banerin ku shkruan "Jo racizmit" me logon e UEFA-s në të, raporton "Sky Sports". Kjo federatë kishte edhe akuza të tjera për skenat në humbjen si vendëse 6 me 0 ndaj Anglisë më 14 tetor. Ndeshja ishte ndërprerë dy herë nga gjyqtari për shkak të thirrjeve raciste. Pos Bullgarisë, Federata e Anglisë është gjobitur me pesë mijë euro për shkak të pengesave gjatë intonimit të himnit.

## Kosova dhe Shqipëria mësojnë kundërshtarët për parakualifikimet e Botërorit

**PRISHTINË, 29 TETOR** - Në Mies të Zvicrës është hedhur shorti për raundin e parë të parakualifikimeve për FIBA Kupën e Botës 2023. Kosova do të jetë në Grupin B, së

bashku me Islandën, Sllovakinë dhe Luksemburgun. Takimet do të zhvillohen me sistem vajtje-ardhje, pra Kosova do të luajë gjashtë ndeshje në

grup. Ndeshjet do të zhvillohen gjatë periudhës 17-25 shkurt 2020, 23 nëntor-1 dhjetor 2020 dhe 15-23 shkurt 2021. Dy kombëtalet e para të grupit do të kualifiko-

hen në raundin e dytë. Ndërsa pjesë e Grupit A është kombëtarja e Shqipërisë, e cila kundërshtarë do t'i ketë Portugalinë, Qipron dhe Bjellorusinë.





## Fury, Joshuas: Po nuk fitove revanshin harroje duelin me mua

Londër, 29 tetor - Boksieri britanik Tyson Fury, ish-kampion bote në peshën e rëndë, ka bërë me dije se nuk do të duelojë me Anthony Joshuan në rast se ky i fundit nuk fiton revanshin ndaj Andy Ruiz Jr. Kjo përballje mes Joshuas dhe

Ruizit do të zhvillohet më 7 dhjetor në Abu Dhabi, me meksikanin Ruiz që mban titujt e peshës së rëndë (IBF, WBA dhe WBO). Fury shprehet të bëhet kampion i padiskutueshëm i botës i këtij Divizioni teksa ka shënjestru-

ar edhe një revansh me Deontay Wilderin, që mban titullin e kategorisë WBC. Gjithsesi, Fury pëlqen më shumë një duel mes dy boksiereve britanikë, mes tij dhe Joshuas, që mund t'i mbushë edhe xhepat. "Nëse Joshua

humbet sërish, nuk ka asnjë shans të duelojë me mua. Më vjen keq, por kjo është e sigurt. Ndaj, e ftoj Joshuan të jetë i kujdesshëm dhe ta fitojë këtë revansh me Ruizin. Unë do të bëj tifo për të më 7 dhjetor", u shpreh Tyson Fury.



## Presioni nga Beogradi nuk i lejon klubet serbe të luajnë në Kosovë

PRISHTINË, 29 TETOR - Federata e Futbollit e Kosovës ka arritur t'i integrojë të gjitha klubet e futbollit të komuniteteve pakicë në garat që organizohen nën ombrellën e saj, përveç klubeve të komunitetit serb, konfirmojnë zyrtarët e kësaj federate. Me gjithë përpjekjet dhe krijimin e kushteve të barabarta për të gjitha klubet, përfshirë edhe ato të komunitetit serb që jeton në Kosovë, siç thonë zyrtarët e Federatës së Futbollit të Kosovës, edhe ato pak klube që dikur ishin pjesë e garave vendore, janë tërhequr për shkak të kushtëzimeve dhe shantazheve nga politika.

Eroll Salihu, sekretari i përgjithshëm i Federatës së Futbollit të Kosovës, ka thënë për Radion Evropa e Lirë se aktualisht asnjë klub i futbollit nga komuniteti serb nuk merr pjesë në gara në ligat e Kosovës. Më herët, sipas tij, kjo federatë kishte arritur të përfshijë në gara dy klube nga ky komunitet, por që më pas politika e Beogradit kishte arritur të ndikojë në ato klube që të largohen nga këto gara. "Janë tërhequr para 6 apo 7 vjetëve, me presionin e madh që u është bërë nga politika serbe. Po e potencoj edhe një rast që, së bashku me presidentin e ndërjet (Fadil) Vokri, patëm pranuar një ekip të femrave të Graçanicës. Kanë pasur fushën dhe u kemi ndihmuar me pajisje sportive, me topa, me të gjitha. Por, një javë para se të fillojnë, atyre u shkoi një vendim që nëse luajnë në këtë ligë do të largohen nga puna nga Komuna e Graçanicës. Kështu që edhe ai projekt ka dështuar. Pra, ekziston vullneti i komunitetit serb që të bëjë gara, por, thjesht, politika serbe nuk i lejon", ka thënë Salihu.

Arbnor Morina, trajner futbollit i licencuar nga UEFA, thotë se mospjesëmarrja e klubeve të futbollit të komunitetit serb në garat e organizuara në ligat e Kosovës është kryekëput për shkaqe politike. Sipas tij, vullneti i sportistëve të këtij komuniteti ekziston për t'u përfshirë në garat vendore, por konkretizimi i këtij vullneti, siç thotë ai, është bërë i pamundur për klubet e komunitetit serb për shkak të frikës nga hakmarrja nga politika. "Ka pasur mjaft investime që komuniteti i serbëve të kyçet në rrjedhat e sportit të Kosovës, mirëpo në të gjithë e dimë se janë tërhequr për shkak të presioneve politike. Sidomos, presioni është rritur në momentin kur në skenën politike, në pjesën jugore (të Kosovës) - pra, po e potencoj, në pjesën jugore - ka hyrë Lista Serbe. Duhet të them se këto presione janë shumë më të fuqishme sesa vetë dëshira e këtyre sportistëve që të marrin pjesë në gara", theksoi Morina.



Se vullneti i klubeve të komunitetit serb ekziston për të marrë pjesë në garat e Federatës së Futbollit të Kosovës e pohon edhe Salihu. Sipas tij, kontaktet me sportistët e atyre klubeve nuk janë ndërprerë. "Gjithmonë jemi në kontakt. Provojmë. Vullneti ekziston. Madje, prej veriut të Kosovës janë lajmëruar edhe për futsall, mirëpo menjëherë, pa para se të fillojnë garat, janë kërcënuar, madje edhe me jetë, siç kemi dëgjuar", tha Salihu.

Morina, i cili dikur ka qenë futbollist i disa klubeve të Kosovës, thotë se kontaktet me ish-kolegët serbë të Kosovës nuk janë shuar dhe se ka mjaft prej tyre që janë të gatshëm të bashkëpunojnë me autoritetet e futbollit të Kosovës. "Por, në anën tjetër është edhe frika prej hakmarrjes, në mënyrë të ndryshme dhe se si do të rrjedhin gjërat nëse ata kyçen në sistemin tonë. Duhet të them se edhe nënkryetari i Federatës është nga komuniteti serb. Individualisht ka disa futbollistë që janë nëpër klube, janë në kategori të reja. Por, krejt kjo është e mbërthyer me një frikë nga ajo se si do të reagojnë ata, të cilët janë të infiltuar përmes politikës dhe se si do t'u hakmerren. Për këtë arsye ekziston kjo barrierë për t'u kyçur ata më shpejt te ne", u shpreh Morina.

Në anën tjetër, klubet e futbollit të komunitetit serb bëjnë gara në organizime të natyrës paralele në Kosovë, si dhe në ligat e Serbisë, të organizuara nga Federata e Futbollit të këtij shteti. Në muajin tetor autoritetet e Kosovës, me kërkesën e Federatës së Futbollit të Kosovës, kishin ndaluar, si të paligjshëm, zhvillimin e një takimi në Zvečan, ndërmjet klubit "Trepça", nga veri i Kosovës, me klubin Cërvena Zvezda (Ylli i Kuq) nga Beogradi. Ky takim ishte paraparë të zhvillohej nën organizimin e Federatës së Futbollit të Serbisë, e vlefshme për Kupën e Serbisë.

## Hasani kërkon që KOK-u të anëtarësohet në FICTS

PRISHTINË, 29 TETOR - Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, është takuar me presidentin e Federatës Ndërkombëtare për Kinemanë Televizive Sportive (FICTS), Franco Ascani, gjatë Festivalit të 17-të Ndërkombëtar të FICTS "Sport Movies & TV", që po mbahet në Milano të Italisë. Sipas njoftimit të Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani ka kërkuar që edhe KOK-u të anëtarësohet sa më parë në FICTS, anëtarë të së cilës federatë

janë edhe 120 shtete të tjera. Nga ana e tij, presidenti Ascani konfirmoi disponimin e madh të tij dhe Komitetit Ekzekutiv të FICTS-s për ta pranuar KOK-un anëtarin më të ri të saj, vendim ky i cili pritet të merret në mbledhjen e KE të FICTS, që do të mbahet pas dy javësh. Hasani, po ashtu, shprehu gatishmërinë që në vitin e ardhshëm edhe Kosova ta organizojë Festivalin e Filmit Sportiv, në të cilin i pranishëm pritet të jetë edhe Franco Ascani.



### SHKURT

#### Buffoni nuk mendon për pension

Gigi Buffoni nuk ka ndërmend të tërhiqet nga futboli as në fund të këtij sezoni kur i përfundon kontrata me Juventusin. Lajmi raportohet nga gazeta torineze "Tuttosport" që i qëndron shumë pranë aktualitetit bardhezi, por gjithçka lidhet edhe me intervistën e dhënë nga Buffoni në emisionin sportiv të Mediaset Tika Taka. "Nuk e shoh veten si drejtues. Dua të luaj akoma. Kur fiziku të mos më lejojë më për të zbritur në fushë, do t'ia bëj të qartë klubit tim se koha ime ka mbaruar". Këto fjalë të Gigi Buffonit të lënë të kuptosh se gardiani italian dëshiron ta rinovojë kontratën me Juventusin të paktën deri në vitin 2021. Vendimin përfundimtar do ta marrë presidenti i Juventusit, Andrea Agnelli.

#### Mane refuzoi Realin

Sulmuesi afrikan Sadio Mane preferoi më shumë të mbetej në Liverpool para se të transferohej në Real Madrid ani pse ishte objektivi kryesor i skuadrës nga La Liga. Lajmin e ka bërë me dije mediumi "Don Balon". Sipas këtij të fundit, "Los Blancos" ishte i gatshëm t'i paguante 180 milionë euro për 27-vjeçarin. Mirëpo, Mane ndihet mjaft mirë te kampioni aktual evropian dhe preferoi më shumë të qëndronte në "Anfield Road". Mane pa dyshim se llogaritet një prej futbollistëve më të mirë në botë.

#### Hazardi: Kjo fanellë ka peshë të madhe

Sulmuesi i Real Madridit, Eden Hazard, ka thënë se është vështirë të luash me fanellën me numër 7, pasi me herët atë e ka bartur Cristiano Ronaldo. "Të veshësh këtë fanellë pas Cristianos nuk është e lehtë, pasi ai është historik", ka thënë Hazard. "Do të bëjmë më të mirën. Duhet të fitojmë trofe. E di që Liga e Kampioneve është e rëndësishme. Jam këtu për ta fituar, ka rëndësi për të gjithë. Edhe unë përfshihem. Jam në klubin më të mirë në botë dhe shpresoj ta bëj më të mirën", ka deklaruar Hazardi.

#### Drogba emërohet ambasador i sigurisë rrugore në Afrikë

Ish-ylli i futbollit afrikan, Didier Drogba, u emërua ambasador i një fushate të Federatës Ndërkombëtare të Automjeteve (FIA) për ta promovuar sigurinë rrugore në Afrikë, u njoftua nga organizatorët. E pagëzuar me emrin "Hapat e sigurt, siguria rrugore në Afrikë", fushata, e cila do të zgjasë dy vjet, do të shpërndajë në tërë Afrikën video, shenja rrugore, faqe interneti etj. Jean Todt, president i FIA-s dhe i dërguari special i sekretarit të përgjithshëm të OKB-së për Sigurinë Rrugore, vlerësoi personalitetin e shquar të Didier Drogbas, famën dhe popullaritetin e tij në të gjithë Afrikën, që përbëjnë një aset të madh për ndryshimin e sjelljes së përdoruesve të rrugës dhe zvogëlimin e numrit të vdekjeve.





<b>Autor:</b> <b>GAZMEND MORINA</b>	KËNGËTARJA NË FOTO	BASHKIMI I HARMONISH-ËM I DISA TINGUJVE TË NJËKOHSHËM	PJESË E NJË PËLHURË E THYER ME DYSH NË VIJË TË DREJTË (shq.)	MOR, HEJ (pashq.)	KËNGËTARJA E FAMSHME ... KIM	FJALË TINGULLIMIT-UESE (shq.)	RESA, SMIRA	<b>EPOKA ERE</b>	PRINCIPIELE	VEND LUFTIMI I GLADIATORËVE	BARI I THARË
MONEDHË E VJETËR ARI ME VLERË PREJ NJËZET FRANGASH								PRAPA			
VEGËL MUZIKORE								TOKA E BUKËS POEZIA E DASHURISË			
DETYRË E AKTORIT				KLUB FUTBOLLI NË BELGJIKË SKITAR							
NËPËR ARA, ARAVE					FLOTA DETARE						
IVAN DAKUR			BASHKËT. ROYAL PHOTOGRAPHIC SOCIETY		ERË E MIRË						ARKEOLOGU SKËNDER
SHTET AZIATIK (pashq.)					TRAJNERI SPANJOLL VILANOVA BASHKËT.					ZANORE KRYEQYTETI KANADEZ	
BASHKËT.		FUTBOLLISTI I NJOHUR BRAZILIAN ALEXANDRE ANA FARIS					BENDI MUZIKOR ".... MAIDEN" POLITIKANI FERID .....				
<b>EPOKA ERE</b>	VESHJE E SIPËRME E TRASHË	FUTBOLLISTI SPANJOLL SERGIO	I PARI I XHAMISË (pashq.)	ZANORE	<b>EPOKA ERE</b>	MUNDËSI PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT		KUTIA E VOGËL PREJ KARTONI MODEL I ZVOGËLUAR I NJË OBJEKTI			
PJESË MUZIKORE PËR TRE INSTRUMENTE OSE PËR TRE ZËRA					HUMORISTI SHQIPTAR ... DEDA BASHKËT.			SHKRONJË GREKE KALIUM, INDIUM		ARBEN MALAJ DRU I ÇMUESHËM QË PËRDORËT PËR ORENDI	
KORNIZË				VEGËL MUZIKORE ENË E METALTË PËR TË SKUQUR VAJIN		REGJISORJA ARZANA VLERA, DOBIA				ISH AKTORJA E FAMSHME GARDNER SHALQI	
I PESHQJ (bised.)					MODELJA AMERIKANE .... TAYLOR MURI I NDËRTUAR ME DËRRASA			NJERINGR-ËNËS BASKETBOLLISTI OBËRTINCA			
KRYENGRIT-ËSI QË DILTE MALIT E LUFTONTE PËR LIRINË E ATDHEUT						BASHKIM QELIZASH TË NJËLLOJTA (sh.pashq.) PËRSËRITËS (gram.)			KËNGËTARJA PERUANE ... SUMAK KADRI ZEKA		ZANORE ROK BEND I YNI
"OSAKA"			GATESË KUSAR			RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS FORMË E TË HYRAVE SHTETËRORE			OKSIGJEN, NITON ANA RUSO		E PËRZJEVE, E TRAZOVE
<b>EPOKA ERE</b>	KËRCËLL I BIMËS SË MISRI	VLERA E MONEDHËS SË NJË SENDI KUNDREJT ARIT KUNDREJT ABSOLUTE						JO BASHKË-TINGËLLORE I PËSHPËRIT DIKUJT FJALË MAGJIKE			
DERA E VOGËL E THURUR ME THUPRA					SHTETI (fr.) GURRAT				QYTET NË ILIRI I THAJ		
REOMIR, ERBIUM				ZËRI I BURRIT NDËRMJET TENORIT DHE BASIT ARTI I VALLEVE ME FIGURA					BASHKËT. SHTET NË AZI (Pashq.)	JEMENI, ANGOLA VEPËR E KRYER, PUNË	
SHTET FEDERAL NË SHBA						MËRIA, ZILIA BASKETBOLLISTI TURK .... ONAN				"K" pas dy "A" ARMENIA	
SPIUNIA E FAMSHME .... HARI					GRIMCË MOLEKULARE GAZ PËR TË PASTRUAR MIRË PLAGËT			KURESHTJE MODELJA KRASNIQI			ZANORE LUFTËTARI GJERGJ .... ALIA
AGIM TEJECI			VAJTIM ME LOT RRJETË E TENISIT				QYTET NË KROACI DES MOINES UNIVERSITY			VITI I RI KINEZ (pashq.) "N" pas dy "P"	
BANOR I KINËS					HUMORISTI BAJRAMI NAPOLI, ATALANTA			NDËRMARRJA PRIVATE KALJARI, ATALANTA		LINDA OSAJ RAMADAN AVDIU	
<b>EPOKA ERE</b>	EMËR YNI MASHKULLI BASHKËT.					FSHAT I MADH NË DRENICË TROPOJA			SHKURTOJ, KRASIT DEGËT E NJË PEME		
CIPA MË E BRENDSHME E KOKËRDHOKUT TË SYRIT (sh.shq.)										KAJDE, OJNA	



Ziraat Bank TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE		
Pasqyra e të ardhurave për tremujorin që përfundon me: 30.09.2019 Euro'000		
	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Të hyrat nga interesi	1,160.01	1,959.00
Shpenzimet e interesit	- 344.73	- 555.51
<b>Neto të hyrat nga interesi</b>	<b>815.28</b>	<b>1,403.49</b>
Të hyrat nga tarifatat dhe komisionet	37.28	63.25
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	- 69.61	- 110.49
<b>Neto të hyrat nga tarifatat dhe komisionet</b>	<b>32.34</b>	<b>47.23</b>
Neto të hyrat nga tregtimi	5.37	4.83
Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare	0.12	0.12
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative	- 755.45	- 1,168.40
<b>Gjithsej të hyrat</b>	<b>32.99</b>	<b>192.80</b>
Provizionet për humbjet nga kreditë	- 139.37	- 177.61
<b>Fitimi/(humbja) para tatimit</b>	<b>- 106.38</b>	<b>15.20</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
<b>Fitimi/(humbja) neto</b>	<b>- 106.38</b>	<b>15.20</b>
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	<b>- 106.38</b>	<b>15.20</b>

Ziraat Bank TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE		
Balanci i gjendjes me : 30.09.2019 Euro'000		
	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
<b>Pasuritë</b>		
Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në	6,479.24	5,752.39
Kërkesat ndaj bankave	350.11	1,369.67
Bonot e thesarit		
Investimet në letra me vlerë	7,004.10	6,760.09
Kreditë dhe parathëniet ndaj klientëve	40,775.52	43,211.41
Patundshmëritë dhe pajisjet	1,144.79	1,100.95
Pasuritë e paprekshme	240.02	224.55
Pasuritë tatimore të shtyra		
Pasuritë tjera	231.87	239.15
<b>Gjithsej pasuritë</b>	<b>56,225.66</b>	<b>58,658.21</b>
<b>Detyrimet</b>		
Depozitat e klientëve	26,431.63	32,640.37
Detyrimet ndaj bankave	11,082.03	6,853.22
Fondet tjera të huazuara	10,503.53	11,004.47
Detyrimet tatimore të shtyra		
Detyrimet tjera	505.64	335.74
<b>Gjithsej detyrimet</b>	<b>48,522.83</b>	<b>50,833.80</b>
<b>Ekuiteti i aksionarëve</b>		
Kapitali aksionar	10,000.00	10,000.00
Rezervat e kapitalit		
Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet paraprake	- 2,190.79	- 2,190.79
Fitimi/(humbja) e vitit aktual	- 106.38	15.20
Përbërësit tjerë të ekuitetit		
<b>Gjithsej ekuiteti i aksionarëve</b>	<b>7,702.83</b>	<b>7,824.40</b>
<b>Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve</b>	<b>56,225.66</b>	<b>58,658.21</b>

Kërkesa për shprehje të interesit  
Emri i shkollës: "Ernest Koliqi" Babush  
Komuna: Lipjan  
Data: 30.10.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/042 ESIP/SDG/042-CS/1.2	Trajnim: GJITHEPERFSHIRJA

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës "Ernest Koliqi" Babush, Lipjan. Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:  
Trajnim: Trajnimi për Gjithpërfshirje

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë. Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë; Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha Gjithpërfshirje (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme Gjithpërfshirje (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK). Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: SHFMU "Ernest Koliqi" Babush Lipjan, më së largu deri më 07.11.2019. Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:  
Personi kontaktues: Fadil Sylejmani  
Telefoni: 044-159-895  
E-maili: fadilsylejmani@outlook.com

Kërkesa për shprehje të interesit  
Emri i shkollës: "Ibrahim Banushi" Shalë  
Komuna: Lipjan  
Data: 30.10.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/043-CS/1.2	Trajnimi për teknologji moduli EXCEL

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës "Ibrahim Banushi" Shalë, Lipjan. Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:  
Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënien

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme.
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë. Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional; Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha Teknologjise (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme apo tjera (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK). Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: SHFMU "Ibrahim Banushi" Shalë, Lipja më së largu deri më 07.11.2019 Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:  
Personi kontaktues: Izet Shala  
Telefoni: 044/274-193  
E-maili: izet.shala@outlook.com





KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS SH. A.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.O.

## FTESË PËR OFERTË

Procedure e shitjes në bazë të rregullores së KRPP-së - Rregullat mbi Qeverisjen e Shitjes dhe Vendorsjen e Aseteve, datë 24 Janar 2012, dhe Rregullat e Përgjithshme të Tenderimit në KEK, për Shitje të Aseteve të Luajtshme, datë 15 Shtator 2009

### SHITJA E MBETURINAVE TE METALIT (SKRAPIT) Procedure e Shitjes Nr. KEK-SHM -19-004-811

Korporata Energjetike e Kosovës sh. a. (KEK), me këtë rast, fton të gjithë blerësit e interesuar të dorëzojnë dokumentet e tenderimit, metoda që do të përdoret -Shitja përmes Ofertave Publike të Mbyllura.

Blerësi fitues do të pranojë mbeturinat e metalit nga TC Kosova B, TC Kosova A dhe Departamenti i Qymyrit, duke përdorur pajisjet vetjake – për përdorim vetjak apo për shitje të mëtutjeshme.

Ofertimi është i hapur për të gjithë ofertuesit e interesuar. Ky aktivitet do të ndërmerret me procedurë të hapur me një zarf.

KEK fton të gjithë blerësit e interesuar të dorëzojnë ofertat e tyre me se voni deri me E Premte, 15.11.2019 në ora 13:00, ndërsa hapja publike e ofertave E Premte, 15.11.2019, në ora 13:30.

Kërkesat për tërheqjen e dosjes së tenderit drejtohen në E-mail adresat vijuese:

Email: [emin.tmava@kek-energy.com](mailto:emin.tmava@kek-energy.com) ose [bledar.racaj@kek-energy.com](mailto:bledar.racaj@kek-energy.com)


[www.kek-energy.com](http://www.kek-energy.com)



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë

Ministarstvo za Inovacije i Preduzetništvo / Ministry of Innovation and Entrepreneurship

Datë: 29.10.2019



### Ftesë për shprehje të interesit, objekt me qira

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë është duke kërkuar objekt me hapësira të përshtatshme për zyra. Të gjithë të interesuarit, objektet e të cilëve përbushin kushtet e përfaqëta të bashkangjitura në këtë shpallje, t'i dërgojnë ofertat me shprehje të interesit dhe dëshmivë përkatëse në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Rruga: "Bajram Kelmendi" K1 L1 - Prishtinë, deri me datë: 08.11.2019, ora: 14:00. E-mail: [burim.guri@rks-gov.net](mailto:burim.guri@rks-gov.net)

Objekti duhet të ketë:

- Hapësirë e përgjithshme 800-900 m<sup>2</sup>,
- Hapësira të jetë sa më afër ndërtesës së Qeverisë,
- Parkingu për së paku 6 automjete zyrtare,
- Ngrohje qendrore çdo ditë pune,
- Pastrimi i objektit çdo ditë pune (të përfshihet në kuadër të çmimit të qerasë mujore e preferueshme),
- Ujë të ngrohët çdo ditë pune,
- Siguria e objektit 24 orë,
- Gjenerator për të furnizuar tërë ndërtesën me energji,
- Klimatizim,
- Dyshemeja e shtruar me parket ose laminat,
- Në rast se objekti është me etazhe (kat) çdo etazh duhet të ketë së paku tualet (wc) për femra dhe meshkuj,
- Shkallë emergjente,
- Telefoni fikse,
- Hapësirë për dhomën e serverëve minimum 16m<sup>2</sup>,
- Hapësirë për depo min 16m<sup>2</sup>,
- Internet për gjithë hapësirën e punës (të përfshihet në kuadër të çmimit të qerasë mujore e preferueshme),
- Ndarja e hapësirave të dizajnohet sipas nevojës së MIN-së për hapësira pune dhe për takime (e negociueshme),
- Objekti do të merret në shfrytëzim (qira) për 1 vit me mundësi vazhdimi,
- Çmimet pas marrjes së ofertës nga OE, mund të jenë të negociueshme,
- Objekti duhet të ketë leje ndërtimi dhe duhet të jetë në Prishtinë. Afërsia me ndërtesën e Qeverisë do të ketë përparësi,
- Të gjithë të interesuarit duhet të ofrojnë planet e objekteve të detajuara me metrazhe.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Gresa Studio" SH.P.K në Prishtinë ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 810121962 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da društvo sa "Gresa Studio" L.L.C, Od Prishtine donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 810121962 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Gresa Studio" L.L.C, In Prishtina has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 810121962 The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË  
OSNOVNI SUD MITROVICA - BASIC COURT OF MITROVICA

GJYKATA THEMELORE  
C.nr.359/2019  
Me dt.28.10.2019  
Mitrovicë

„GAZETA ZYRTARE „ E REPUBLIKES SE KOSOVES

PRISHTINË

Në bazë të nenit 83 të Ligjit mbi procedurën kontestimore të Kosovës kërkojmë të publikoni këtë,

SH P A L L J E

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, në qështjen juridike të paditësit: Adem Ibrahim nga Mitrovica, kundër të paditurit: Jeliq Milosav (UD. Lepsava e lindur Jakiq) nga Mitrovica tani me vendbanim të panjohur, baza e kontestit: Vertetim pronësie, në bazë të nenit 79.pika 3-a e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të Kosovës të paditurit: Jeliq Milosav Lepsava i caktohet përfaqësuesi i perkohshëm av. Drita Shaban haxhaj nga Mitrovica.

Përfaqësuesi i perkohshëm do të përfaqësoi të paditurin në këtë çështje juridike deri sa ai apo i autorizuari i tij të paraqiten në këtë gjykatë.

GJYQTARI,  
Ragip Kadriu




RESTAURANT

**SWISS**

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553


PRISHTINË


 **Gjeje PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:


- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




facebook  [www.facebook.com/gjejepuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejepuneshpejte)

**Lume's Details**

Estetik & Depilim





044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

- ▶ Kërkoj shporet për nxehe qendrore me dru të përdorur, që mundet të ngrohe deri 1000 m2, numri kontaktues 044-608-626.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.
- ▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesa mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.
- ▶ Shesim banesën dy dhomshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit, çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387
- ▶ Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.
- ▶ Lëshoj garsonierën me qira 13 m2 kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Ulpiana objekti C7 kati i 3 hyrja e II-të nr 11 ka 50 m2 dy dhomshe, një banjo, kuzhinë të gjitha të reja, është e përshtatshme për zyre edhe apo ordinancë. Për informata në tel; 044/641-524 dhe + 46705793508.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria -Vlada-Government*



*Ministria e Mbrojtjes*  
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense  
Drejtoria e Burimeve Njerëzore / Direktorat Ljudskih Resurs  
Human Resources Directorate

# KONKURS

**PËR REKRUTIMIN E KADETËVE PËR SHKOLLIM NË AKADEMINË E FORCAVE AJRORE  
DHE AKADEMINË USHTARAKE –WEST POINT TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS**

**Afati i konkurimit:**

**Konkursi është i hapur prej 22.10.2019 deri më 04.11.2019.**

**Ministria e Mbrojtjes iu shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës  
dhe mirëpret aplikacionet e të gjithë kandidatëve të interesuar  
pa dallim gjinie, race dhe përkatësie etnike.**

Konkursi dhe formularët për aplikim janë në dispozicion në Komandën e Forcave Tokësore  
dhe në ueb-faqen e Ministrisë së Mbrojtjes, [www.mod.rks-gov.net](http://www.mod.rks-gov.net).  
Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr.tel. 038-603-355.

